

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7758 E mërkurë 9 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Nga BILIM AHMETAJ



Që me 5 dhjetor, kur studentët "befasisht" protestuan në një formë që ia kishim harruar shijen, kam qenë në mbështetje të protestës së studentëve ...
Vijon në faqen 20

Kush e do më shumë Shqipërinë se partinë, t' u bashkohet studentëve

Opinion i Ditës

Nga RIGELS LENJA



Prej gati 27 vitesh SHBA-të kanë luajtur të vetëm (në shumicën e rasteve), rolin e "policit botëror". Shumëkush do thoshte se SHBA-të nuk janë asgjë ...
Vijon në faqen 21

Pse SHBA-të i duhen sistemit aktual botëror



"Angjelinën e rrihte edhe xhaxhai"

Shqiptarja që u vra nga i ati, i dashuri afgan: I propozova që të martoheshim

Krimi në Greqi/ Trupi i 29-vjeçares mbërrin në Berat. Babai e goditi 7 herë me levë hekuri

BERAT - Pak ditë pas vrasjes makabre në Korfuz të Greqisë, ka mbërritur dje në Berat trupi i pajetë i Angelina Petros. Mësohet se nëna e 29-vjeçares, Xhezmiye Stoçeni kishte shkuar në Korfuz së bashku me të afërmit të saj për të tërhequr trupin e së bijës, e cila u masakrua për vdekje dhe u gropos në oborrin e shtëpisë nga i ati, Aleko Petro ...
Në faqen 11

AVOKATI I SHTETIT: SHUMA DERI NE 10 MIJE EURO SHPERNDAHET MENJEHERE

KOMPENSIMI I PRONAVE, JA SI NDRYSHON PROCEDURA

Amendimet në ligj përcaktojnë rregullat dhe afatet e reja. Ata që kanë fituar dëmshpërblim me vendim të Gjykatës së Strasburgut u kalon fondi brenda 30 ditëve



(Në foto) Gjykata e Strasburgut. Avokati i Shtetit, Artur Metani

KRIMI NE FAMILJE

Vrasja e dy grave në Ballsh, vëllai i viktimave pësoi vdekje klinike

Në faqen 7

ARSIMI I LARTE

Studentët: Nuk tërhiqemi, protesta vazhdon. Rama: Do paguani 50% tarifë

Në faqen 3

"VIP PAGES"

Shqiptarja që kandidon për deputete në Zvicër: Mbroj idetë liberale

Suplement

BOTIMI I RI

Kolec Topalli: Petro Marko në shtëpinë time dhe jeta në kampin e Tepelenës

Në faqet 18-19

REKORDI, FLAMUR NOKA ME 6 HERE



Sherret në Kuvend, 21 deputetë janë përjashtuar në dy legjislatura

Në faqen 5

Zbardhen datat e provimeve të Maturës Shtetërore, procedura për mbetësit

Bursat në shkolla, kriteret për të përfituar

Nxënësit e 9-vjeçares dhe gjimnazit, kuota për ushqime dhe konviktin

NGA VOLTIZA DURO

Sipas vendimit më të fundit të qeverisë, nxënësit e arsimit parauniversitar në vend mund të marrin bursë apo përfitime të tjera, nëse përmbushin kushtet e përcaktuara. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot kriteret ekonomike



që duhet të plotësojë nxënësi si dhe masat e bursave që do të jepen për vitin mësimor 2018-2019. Gjithashtu, gazeta publikon edhe kuotat financiare sipas normave për ushqimin dhe veshmbathjen sipas kategorive përkatëse ku nxënësit bëjnë pjesë. "Nxënësit ...
Në faqet 8-9

STUDENTËT PROTESTA

Sot nis dorëzimi i dokumenteve për përfitimin nga reduktimi i tarifës së shkollimit

Pagesa e tarifës, Rama-studentëve: Mos paguani më shumë se 50%

"Fundërrina të universitetit po dizinformojnë studentët"

Kryeministri Edi Rama reagoi dje në rrjetet sociale lidhur me protestën e studentëve, që rinisi ditën e hënë. Në një postim në "Twitter", ai shprehet se po dizinformohen studentët për paketën e tarifave. Në këtë mënyrë, kryeministri u bëri thirrje studentëve që të mos paguajnë më shumë se 50% të tarifës, sikurse u vendos nga qeveria. Këta persona që po dizinformojnë, kryeministri Edi Rama i quan "fundërrina të universitetit". "Pëngmarësit që e degjeneruan protestën studentore në mblyllje dyersh me dhunë e në shfaqje rrugore të brutalitetit të injorancës, po përpiqen të dizinformojnë studentët lidhur me tarifën në bashkëpunim me disa fundërrina të universitetit! Askush të mos paguajë më shumë se 50%. Është miratuar në dhjetor VKM-ja për të paguar 50% të tarifave për të gjithë (100% për ata me 9/10 e me ndihmë ekonomike+bursë 10 mijë lekë) dhe qeveria do t'ua kalojë lekët direkt universiteteve një për një brenda janarit! Fryma e qëllimit e protestës janë tanimë pjesë e rrugës sonë", shkruan kryeministri Edi Rama.



Kryeministri Edi Rama

VENDIMI

"Askush të mos paguajë më shumë se 50%. Është miratuar në dhjetor VKM-ja për të paguar 50% të tarifave për të gjithë (100% për ata me 9/10 e me ndihmë ekonomike+bursë 10 mijë lekë) dhe qeveria do t'ua kalojë lekët direkt universiteteve një për një brenda janarit! Fryma e qëllimit e protestës janë tanimë pjesë e rrugës sonë", - tha z.Rama.

PD, thirrje pedagogëve: Firmosni për anulimin e ligjit për arsimin

Deputeti i PD-së, Luçiano Boçi, u bëri dje thirrje pedagogëve t'i bashkohen protestës së studentëve dhe të bëhen firmëtarë të anulimit të Ligjit për Arsimin e Lartë. Deputeti demokrat në një postim në faqen e tij të "Facebook"-ut thekson se pedagogët nuk duhet të heshitin përballë kushteve skandaloze në të cilat japin mësim, por edhe persekutimit që po u ndodh nga qeveria. Ndaj, ai u bëri thirrje të bashkohen me studentët kundër ligjit për arsimin e lartë. "Mos kenifrike nga zgjidhja politike. Dija juaj është më e fortë se çdo politikë dhe se çdo dhunë që pjell pushteti. Bëhuni një me studentët e me kolegët



DENONCIMI

Kreu i PD në Vlorë, Genc Deromemaj, akuzoi dje PS-në dhe politikën korruptive që ka ndjekur kjo e fundit karshi buxhetit të bashkisë, duke e përdorur për punësimin e militantëve partiakë.

pedagogë, firmëtarë të abrogimit të Ligjit të Arsimit të Lartë. Vepër e mirë nuk është vetëm puna shkenore e mësimore. Vepër që hyn në histori është dhe puna e detyra

qytetare, për të rivendosur demokracinë e humbur. Mos harroni! Qytetarët e studentët besojnë ende tek ju dhe vlerat tuaja", shkruan Boçi.

sa, referuar VKM-së së nxjerrë po në fund të dhjetorit, duke dorëzuar kështu të gjitha dokumentacionet përkatëse. Rama shkruan se të gjithë studentët, e çdo universiteti, duhet të kërkojnë ekzaktësisht këtë njoftim. Ky reagim vjen pas sqarimit për një njoftim që po qarkullonte në mediat 'online' dhe në

rrjetet sociale, ku në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit kërkohet që studentët të bënin pagesën e plotë të tarifës vjetore deri më 28 janar. Edhe më herët Edi Rama u shpreh se kjo nuk është e vërtetë dhe se të gjithë studentët do të paguajnë tarifë të përgjyshme, ose nuk do të bëjnë asnjë pagesë,

në varësi të statusit të tyre social. Studentët vijojnë protestën e tyre, ndonëse numri i protestuesve është tkurrur ndjeshëm në krahasim me protestat e kaluara. Studentët kundërshtojnë VKM-në dhe kërkojnë plotësimin e 9 kërkesave të tyre, duke përfshirë edhe anulimin e Ligjit për Arsimin e Lartë.



Protesta e djeshme e studentëve

Kërkesat e studentëve, Spahia: Rama po mashtron me VKM

Deputeti i PD-së, Bardh Spahia, hodhi dje akuzë mbi kryeministrin Edi Rama, që sipas tij po mashtron studentët. "O njeri që shpërfytyrohesh ngaqë nuk je më i besueshëm për askënd: ke nxjerrë disa VKM vërtetë për studentët, por asnjë prej vendimeve në interes të tyre nuk ka një futurë financiare, as në Fletoret e fundit të dt. 4 dhe 7 janar. E sidomos VKM-ja që u përgjyshmon tarifën e ka të theksuar se vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare. Pra, o njeri, mjaft i gënjeve studentët me premtime në letër! Ti nuk ke një futurë financiare për ta, se për të kompensuar, së pari përgjyshmin e tarifës, diku duhen gjetur fondet, tejet e vështirë pa një rishikim të buxhetit siç ta kërkoj opozita e siç ta dha mundësinë presidenti me kthimin e buxhetit, por që ti nuk ua vure veshin!", - shkruan Spahia.



Unaza e Re, Balliu-Ramës: Larg duart, ose do marrësh atë që s'e ke imagjinuar

Banorët e Unazës së Re protestuan edhe dje kundër përfundimit të banesave të tyre duke bllokuar trafikun. Ata shprehen se do të vijojnë që të qëndrojnë në protestë deri ditën kur të anulohet projekti i Unazës së Re. I pranishëm në protestë ishte edhe deputeti demokrat, Klevis Balliu, i cili i bëri thirrje kryeministrin Edi Rama të heqë dorë nga projekti, ose në të kundërt do të marrë "shuplakën përfundimtare". "Nuk do të stepemi, do të qëndrojmë të bashkuar, nuk do të ikim derisa projekti të anulohet. Rama duhet ta marrë qartë mesazhin, larg duart nga studentët dhe Unaza e Re, ose në të kundërt do të marrësh atë që nuk e ke imagjinuar, shuplakën përfundimtare".





PRESIONI

Ndaj studentëve po ushrohet presion e këtë e shpjegojmë më së miri arrestimi i dy shokëve të tyre dy ditë më parë. Kina nënvizon se deri më tani nuk ka përçarje mes studentëve, dhe bojkoti i mësimit vazhdon, pavarësisht tentativave për të nisur mësimin nga disa studentë që kanë frikën e mungesave.



MASR kërkon informacione për numrin e studentëve që përfitojnë bursa

Institucionet e arsimit të lartë në vend duhet të paraqesin pranë Ministrisë së Arsimit, numrin total të studentëve që përmbushin kriteret për të përfituar ulje tarifash dhe bursë. Njëpërjet një njoftimi për median, mbërmen e djeshme, MASR thekson se ky informacion kërkohej për plotësimin e kërkesave të studentëve. Në përmbushje të angazhimeve të qeverisë shqiptare për plotësimin e kërkesave të studentëve, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me prioritet, po angazhohet maksimalisht në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë, për sigurimin e një informacioni sa më të plotë për identifikimin e numrit të studentëve, si dhe përcaktimin e programit ku ata ndjekin studimet e tyre, për të gjitha kategoritë e parashikuara në secilin prej vendimeve nr.778, 779, 780, 781, 782 dhe 784, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka kërkuar pranë çdo institucioni publik të arsimit të lartë informacion lidhur me numrin total të studentëve që përfitojnë, në rast të plotësimit të kriterëve të përmendura në Vendimet e Këshillit të Ministrave të sipërcituar për tarifën dhe bursat", theksohet në njoftim. Informacioni duhet të dorëzohet brenda 11 janarit të këtij viti. "Strukturat përkatëse pranë universiteteve publike janë angazhuar plotësisht për të mundësuar brenda datës 11.01.2019 gjithë informacionin e nevojshëm. Pas marrjes së këtij informacioni do të vijohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të lëvrohet fondi i nevojshëm për subvencionimin e IAL-ve publike në përballimin e efektit financiar, në zbatim të vendimeve", bën me dije MASR. Ndërkohë sekretarët mësimore pranë universiteteve dhe administratorët do të bëjnë njoftimin e nevojshëm për studentët, në një kohë që veprimtaria e tyre do të monitorohet për të mos pasur asnjë keqinformim apo veprim në kundërshtim me vendimet e marra nga Këshilli i Ministrave.

Kryetari i Senatit Akademik të UT: Qeveria ka frikë, ushtron presion ndaj nesh

Studentët: Protesta do të vazhdojë pavarësisht tentativave për përçarje

Kristian Kina: Kërkojmë plotësimin e 8 kërkesave tona

Voltiza Duro

Studentët e universiteteve publike në vend kanë bojkotuar sërish mësimin ditën e djeshme dhe kanë marshuar nga fakultetet drejt godinës së Kryeministrit me pankarta në duar. Të rinjtë shprehën të vendosur se nuk do të tërhiqen deri në plotësimin e 8 kërkesave të tyre dhe sipas tyre pikat e tyre pothuajse nuk janë realizuar nga vendimet e marra nga qeveria të përfshira në Paktin për Universitetin. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Kristian Kina, kryetar i Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës tregon se protesta do të vazhdojë pavarësisht tentativës për përçarje të qeverisë dhe segmenteve të caktuara akademiko-politike. Ai shton se tashmë ndaj studentëve po ushrohet presion e këtë e shpjegojmë më së miri arrestimi i dy shokëve të tyre dy ditë më parë. Kina nënvizon se deri më tani nuk ka përçarje mes studentëve, dhe bojkoti i mësimit vazhdon, pavarësisht tentativave për të nisur mësimin nga disa studentë që kanë frikën e mungesave. Studenti shton se përçarje po tentohet të krijohet nga qeveria, duke nisur artificialisht një luftë mes studentëve dhe pedagogëve.



Kristian Kina, kryetar i Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës

Përçarja



STUDENTET

Përçarje mes studentëve nuk ka, por duke mos pasur një kryesi përfaqësuesish mbase nuk konvergjojnë gjithmonë idetë në një pikë, por është normale në një grupim prej mijëra studentësh. Bojkoti i mësimit vazhdon, pavarësisht tentativave për të nisur mësimin nga disa studentë që kanë frikën e mungesave. Përçarje po tentohet të krijohet nga qeveria, duke nisur artificialisht një luftë mes studentëve dhe pedagogëve.

KËRKESAT E STUDENTËVE

- Përgjysmimin e tarifave në të gjitha nivelet e studimit (sidomos në master);
- Rritjen në 50% të peshës së votës studentore;
- Dyfishimin e buxhetit të shtetit për universitetet publike;
- Ndalimin e financimit publik të universiteteve private;
- Asnjë kërkesë nuk mund të realizohet pa rrezimin e ligjit të arsimit të lartë;
- Kartë e Studentit të hyjë në fuqi e të jetë funksionale

Ditën e sotme studentët sërish kanë bojkotuar mësimin dhe kanë protestuar. A do të vazhdojë qëndrimi juaj deri në plotësimin e kushteve?

Patjetër që po. Protesta jonë do të vazhdojë pavarësisht tentativës për përçarje të qeverisë dhe segmenteve të caktuara akademiko-politike.

Krahasuar me protestat në dhjetor, numri i studentëve protestues ka pasur rënie. A po tërhiqen një pjesë e studentëve?

Jemi në një situatë delikate, sepse dhe studentëve po u ushrohet presion, duke mos harruar dhe faktin se 2 prej shokëve tanë u arrestuan.

A ka përçarje mes studentëve?

Përçarje mes studentëve nuk ka, por duke mos pasur

një kryesi përfaqësuesish mbase nuk konvergjojnë gjithmonë idetë në një pikë, por është normale në një grupim prej mijëra studentësh. Bojkoti i mësimit vazhdon, pavarësisht tentativave për të nisur mësimin nga disa studentë që kanë frikën e mungesave. Përçarje po tentohet të krijohet nga qeveria, duke nisur artificialisht një

luftë mes studentëve dhe pedagogëve, me qëllim penetrimin e saj në stafet akademike drejtuese.

Cilat nga kërkesat tuaja janë plotësuar me miratimin e vendimit të paktit për universitetin?

Nuk dua të futem në çështje teknike, se pikërisht këtë kërkon kryeministri Edi Rama. Linja e studentëve

është që duan akoma përgjysmim të plotë të tarifës së masterit për të gjithë studentët, pavarësisht mesatares, duan përfaqësim më të madh në organet vendim-marrëse për studentët, duan Kartën e Studentit funksionale dhe jo premtime boshe si në këto 28 vjet.

A ka pasur konfrontime me forcat policore që ishin të pranishme në disa fakultete ditën e sotme (djeshme)?

Nuk ka pasur asnjë konfrontim me policinë, përveç rastit të arrestimit të dy prej shokëve tanë dy ditë më parë. U liruan pas disa orësh, por vetë fakti i shoqërimit të tyre, arsyjeja që e shtyu Policinë e Shtetit të merrte këtë hap është për t'u shqetësuar dhe njëkohësisht, tregues i frikës që ka kjo qeveri nga studentët.

Ka pasur studentë që i janë rikthyer mësimit?

Një numër shumë i vogël studentësh kanë shprehur dëshirën për mësim, por në shumicën dërrmuese të rasteve nuk janë zhvilluar leksionet, sepse kanë qenë në shifra minimale studentët në auditor.

Cili është opinionin tuaj mbi deklaratat e kryeministrit Rama mbi protestën tuaj dhe sa ekziston mundësia për të pasur një negociim apo bashkëbisedim me kreun e qeverisë?

Dialogu me Kryeministrin Edi Rama gjendet te fleta me 8 pikat. Kjo formë dialogu nuk kërkon përfaqësi studentësh, thjesht vullnet pozitiv nga ana e tij.

Cilat do të jenë hapat tuaj të mëtejshëm?

Hapat e mëtejshëm nuk janë ende të koordinuara në universitetet e tjera, por një gjë është e sigurt: Studentët e bashkuar kanë për të fituar!

OPOZITA REAGIMI

LSI: Reagim i ashpër kundër qeverisë, protesta mund të shpërthejë nga çasti në çast

Valentina Madani

Opozita po përgatit terrenin për një protestë masive kundër qeverisë "Rama". Partitë opozitare kanë zbritur përfaqësitë e tyre në bazë për të mbledhur sa më shumë njerëz në kryeqytet. Ende nuk ka një datë fikse se kur do të nisë reagimi i ashpër i opozitës i paralajmëruar prej kohësh, por vonesat mësohet se janë bërë për shkak se në është lënë deri tani hapësirë studentëve për të protestuar në mbrojtje të kërkesave të tyre. Por duket se opozitarët nuk do të presin shumë gjatë për t'u derdhur në shesh kundër keqeverisjes së majtë. Një gjë të tillë e sinjalizoi dje kreu i deputetëve të LSI-së Petrit Vasili, një prej deputetëve mjaft aktiv të opozitës në denoncimet ndaj qeverisë "Rama". I pyetur se kur do protestojë opozita në shesh ndaj kësaj qeverie, deputeti i LSI u shpreh se ajo mund të shpërthejë nga çasti në çast. "Protesta e opozitës ka të bëjë me atë që quhet protesta e madhe në shesh dhe nuk ka munguar. Ajo mund të shpërthejë nga çasti në çast, por është krijuar një raport për t'u lënë hapësirë studentëve. Opozita proteston çdo ditë, pasi është në mbështetje të qytetarëve. Banorët e Astirit kanë mbështetjen tonë. Do ketë edhe një kulm që do vijë e natyrshme, pasi kjo qeveri e shurdhër do rëpallet me një reagim të rreptë dhe të ashpër. Ka një sinkron me PD për sfidat. PD-LSI është në front të sinkronizuar për të mbrojtur çështjet parimore"- theksoi z.Vasili. Kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili dha alarmin se vendi ndodhet në emergjencë kombëtare. Vasili tha në News24, se shqiptarët e shikojnë të ardhmen vetëm jashtë vendit dhe protesta e studentëve evidenton regjimin që qeveris sot. "Protesta e studentëve evidentoit regjimin injorant që qeveris sot. Kryeministri frikshëmrisht injorant dhe i paditur sfidohet nga një brez i ri. Fatet e Shqipërisë janë më të rëndësishme se fatet politike. Shqipëria është në emergjencë kombëtare. Jemi në emergjencë politike, ekonomike dhe shoqërore. Kemi emigracionin më të madh. Shqiptarët e shikojnë të ardhmen vetëm jashtë vendit. Kemi emigracionin më të madh për të miturit nga 7-14 vjeç në Evropë"- tha Vasili. Sa i përket zgjedhjeve lokale të qershorit, Vasili tha se: "Përgatitjet për zgjedhjet lokale janë të leh-

Opozita gati për protesta: Pas studentëve, të gjithë në shesh

Shtyrja, prej lënies së hapësirës për studentët

ta dhe të natyrshme. Por për ne problemi madhor është përballja me qeverisjen e krimit në ditët e sotme. Fronti opozitar do reflekto-

het në zgjedhjet lokale". Më herët kryetari i grupit parlamentar të LSI-së Petrit Vasili sulmoi ashpër kryeministrin Edi Rama

dhe emrat e propozuar nga ai për ministra. Përmes një postimi në "Facebook" Vasili ngre pyetjen se pse Rama ua besoi ministrinë kryesore

disa anonimëve. Mes të tjerash ai kujton një shprehje të Giovani Falcone, ndërsa shton: "Aty ku sundon mafia jo rastësisht institucionet e rëndësishme i besohen injoranteve dhe anonimëve". "Pse Edi Rama ua beson ministrinë kryesore anonimëve dhe injoranteve? Përgjigjen shteruese e ka dhënë ai që luftoi dhe dha jetën në luftën kundër mafias Giovani Falcone, i cili thoshte: "Aty ku sundon mafia jo rastësisht institucionet e rëndësishme i besohen injoranteve dhe anonimëve", shkruan Vasili. Krerët e opozitës kanë deklaruar se do të mbështesin çdo protestë të qytetarëve kundër arrogancës së qeverisë së majtë.



Gjate një seance parlamentare



Protesta e fundit e opozitës

PROTESTA

Protesta e opozitës ka të bëjë me atë që quhet protesta e madhe në shesh dhe nuk ka munguar. Ajo mund të shpërthejë nga çasti në çast, por është krijuar një raport për t'u lënë hapësirë studentëve. Opozita proteston çdo ditë, pasi është në mbështetje të qytetarëve. Banorët e Astirit kanë mbështetjen tonë.

Deputetja e PD: Nismat e PS po varfërojnë shqiptarët

Tabaku: Rrënim i shtresës së mesme në 5 vitet e qeverisë Rama

Deputetja e PD, Jorida Tabaku argumenton atë që ajo e quan "Rrënim i shtresës së mesme në 5 vitet e qeverisë Rama". Së pari, ajo parashtron rritjen e vazhdueshme të taksave dhe tarifave, e sipas saj: "Kjo ka penalizuar në masë bizneset e vogla vendase, ka stopuar rritjen e investimeve të huaja si dhe ka ndikuar dhe në buxhetin e familjeve që fatkeqësisht sot është i njëjtë me atë të 10 viteve më parë". "Mbi të gjitha shtresa që është penalizuar maksimalisht gjatë këtyre pesë viteve është shtresa e mesme. Pedagogët, inxhinierët, profesionistët e lirë, mjekët, arkitektët e juristët, pra shtresa e punës mendore, shtresa e zbatimit të dijës është penalizuar në shumë duke u taksuar shumëfish për punën që bëjnë! Ka bizneset të vogla me tatim më të ulët, ka dhe fitime kompanish që ta tohen më ulët, dhe kapitali ta tohet



më ulët, por jo qeveria e Edi Ramës vendos të ketë tatimin më të lartë për punën", shkruan Tabaku. Më tej ajo shpreh se "Një tjetër dhuarë që qeveria u kujdes t'i bënte shqiptarëve është ajo e rritjes së pagës maksimale, efekti i së cilës do të bëjë mbi



AKUZA

"Taksa progresive e vrau punën dhe shtresën e mesme (profesionet e lira, gjithashtu) ndërkohë që krijoi terrenin për varfërimin e mëtejshëm të shtresës së mesme. Kjo lëvizje e fundviti prodhon një tjetër goditje për punën dhe biznesin duke e thelluar edhe më tej krizën e punës, pagave, konsumit dhe rritjes ekonomike".

rritjen e sigurimeve shoqërore më shumë se sa në rritjen e të ardhurave. Konkretisht, vendosja e pagës maksimale prej 150 mijë lekësh përkatësitë në një rritje të detyrimeve për sigurime dhe shpenzimet e biznesit". Një tjetër manovër të

gabuar, sipas saj, është edhe rritja e kostos me 10% të një të punësuarit: "Në total, një biznesi të madh koston e shtuara nga kjo lëvizje e ditëve të fundit të qeverisë do t'i kushtonte shtrenjtë. Nëse marrim në referencë vetëm biznesin e call center (që punëson shumicën dërrmuese të të rinjve në vend), kjo kosto ndikon në rritjen e shpenzimeve me rreth 30 mijë euro në muaj. Çfarë do të thotë kjo? Që biznesi për të paguar këtë kosto që i lind vetëm në datë 30 dhjetor do t'i duhet të ulë shpenzimet e pagave (duke ulur pagat) apo duke larguar të punësuarit". Sipas saj këto zgjedhje nuk e rrisin konsumin dhe as nuk ulin hendekun mes të varfërve dhe të pasurve.

Njoftim për shitje me anka

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e parë të pasurisë të palës debitore Shoqëria "ARNI" sh.p.k, Paeuria që delane ankand të pare përbëhet nga : "Apartament", me Nr pasurie 69/11/ND +1-14 ndodhur ne Rr "Dodona", Hytja nr.1, Kati 3 Ap 14, Oriktum e regjistruar ne ZVRRP- Vlore , Z K Nr.2832, volumi 16, faqe 120, me sipër 43 m2

Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në masën 1.920.000 lekë Ankandi do të zhvillohet në datë 25.01.2019 në orën 15:00 në selinë "Bul "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5. Kontakt 0672082543 ilir.dervishaj@yahoo.com faqen WEB www.powerjustice-al.com

Njoftim për shitje me anka të tretë

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar ne nenin 568,577 e vijues te K.P.L.C do të zhvillojë ankandin e tretë për pasurinë e palës debitore B Kambaraj dhe L Kambaraj Pasuria që shitet në anka përbëhet nga : "Trulli + Godinë", me numër pasurie 14/283 ndodhur në Lagen 10 Korriku dhe e regjistruar pranë ZVRRP- Vlorë, e ndodhur në Z.K.Nr.6622, volumi 35, faqe 144, me sipërfaqe trulli 300 m2, sipërfaqe e kati përdhë 117,9 m2. Ankandi i tretë fillon me çmimin fillestar në masën 5.644.800 Lekë

Ankandi qendron i hapur 30 ditë dhe do të zhvillohet në datë 23.01.2019 në orën 15:00 në Bulevardi "Gj.Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5, Tiranë Olfertuesi duhet të bërëqin dokumentacionin si dhe te kontakt. tel. 07 20 82 543 e-mail ilir.dervishaj@yahoo.com ose WEB www.powerjustice-al.com

Marrja e shtetësisë, Meta: Procedurat që duhet të ndiqen

Presidenti Ilir Meta iu përgjigj dje ankesës së një qytetari nga Kosova, i cili shprehet se ka aplikuar për shtetësinë shqiptare dhe i është refuzuar kërkesa. Përmes një sqarimi konkret, në përgjigje të një shtetasi të Kosovës, që kërkon pasaportë shqiptare, Meta tregon se si duhet të veprohet. Në rastin konkret, personi që ankohet është djale i dy prindërve që kanë pasur shtetësinë shqiptare, por që jeton në Kosovë dhe siç është ankuar, i është refuzuar kërkesa për të marrë pasaportën shqiptare. Meta informoi se në Presidencë nuk ka asnjë praktikë për këtë kërkesë duke i dhënë numrat e telefonit ku mund të informohet për këtë çështje, lidhur me gjithë procedurat që duhen ndjekur. "Përsëritet z.Peposhi! U informova nga administrata për rastin tuaj dhe nga verifikimi i kryer rezultoi se në Institucionin e Presidentit të Republikës nuk ka asnjë praktikë të administruar me emrin Naim Peposhi. Ndoshta këto kërkesa janë depozituar në Ministrinë e Brendshme, por për sqarime të mëtejshme në lidhje me procedurat e marrjes/fitimit të shtetësisë shqiptare dhe trajtimin sipas ligjit, ju mund të kontaktoni në këto numra +35542389801; +35542389853 me zyrën përkatëse që trajton çështjet e shtetësisë. Gjithashtu, kur të jeni në Tiranë nëpërmjet numrave të mësipërm, ju mirëpres për një takim miqësor në zyrën time", - shprehet z.Meta.



VENDIMET E BYROSË SË KUVENDIT

- Më datë 22.12.2018 Byroja e Kuvendit mori masën disiplinore "përfundim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 10 ditë për deputetët Flamur Noka dhe Gent Strazimiri,
- Më datë 20.12.2018 Byroja mori masën disiplinore "përfundim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 10 ditë për deputetin Endri Hasa,
- Më 12.04.2018 Byroja e Kuvendit mori masën disiplinore për përfundim në 10 ditë nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për deputetët: Flamur Noka, Ervin Salianji, Klevis Balliu, Edi Paloka, Kejdi Mehmetaj dhe Endrit Brahimllari,
- Më 21.12.2017 Byroja e Kuvendit mori masën disiplinore "Ndalimi i pjesëmarrjes në komisione dhe në seancë plenare për 10 ditë" për deputetët: Monika Kryemadhi, Endrit Brahimllari, Ervin Salianji, Endri Hasa, Flamur Noka dhe Bardh Spahia. Gjithashtu, në këtë mbledhje u morën masa disiplinore "Ndalimi i pjesëmarrjes në komisione dhe në seancë plenare për 5 ditë për deputetët: Kejdi Mehmetaj dhe Bujar Çela,
- Më 12.10.2017 Byroja e Kuvendit mori masën disiplinore "përfundim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 10 ditë për deputetin Flamur Noka,
- Më 06.02.2017 Byroja e Kuvendit mori masën disiplinore "përfundim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 10 ditë për deputetin Flamur Noka,
- Më 23.11.2016 Byroja e Kuvendit mori masën disiplinore "përfundim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 10 ditë për deputetin Flamur Noka,
- Më 21.11.2016 Byroja e Kuvendit mori masën disiplinore "përfundim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 5 ditë për deputetin Edi Paloka,
- Më 21.06.2016 Byroja e Kuvendit mori masën disiplinore "përfundim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 5 ditë për deputetin Edi Paloka,
- Më 27.05.2016 Byroja e Kuvendit mori masën disiplinore "përfundim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 10 ditë për deputetin Sali Berisha,
- Më 07.04.2016 Byroja e Kuvendit mori masën disiplinore "përfundim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 5 ditë" për deputetët, Erjon Braçe, Roland Keta, Edi Paloka dhe Arben Ristani, si dhe masën disiplinore "vërejtje" për deputetin Sali Berisha,
- Më 26.02.2016 Byroja e Kuvendit mori masën disiplinore "përfundim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 7 ditë për deputetët Gent Strazimiri dhe Bedri Hoxha, si dhe mori masën disiplinore "përfundim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 2 ditë për deputetin Albina Dede,
- Më 11.07.2014 Byroja e Kuvendit mori masën disiplinore "përfundim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 7 ditë për deputetin Arben Noka dhe masën disiplinore "përfundim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 3 ditë për deputetin Pjerin Ndreu. Gjithashtu gjatë kësaj mbledhje mori edhe masën disiplinore "vërejtje" për deputetin Gent Strazimiri,
- Më 19.06.2014 Byroja e Kuvendit mori masën disiplinore "përfundim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 10 ditë" për deputetin Sali Berisha
- Më 28.05.2014 Byroja e Kuvendit mori masën vërejtje për deputetët Armando Prenga, Xhemal Qefallia, Gentian Bejko, Gent Strazimiri.

Medar KAJOLLI Përmbarues Gjyqësor Privat me seli në Rr. "Urani Pano" Pll.1/3, Kat-2, Tiranë, ndjerr në shtitje në ankand pasuritë e paluajtshme si me posthë;

Pasuria Nr. 1/574, Vol.-32, fq.-207, Z. K-81/10, Illoji Njësi me Sip.-32 m2, Tiranë, me vlerë 3591/072 (Tërë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëdhjetë e dy) Lekë, - në pronësi të debitorit Z.Besnik Binaku.

Shtija e pasurive të paluajtshme do të behet (Zhvillohet) në date 11.01.2019, ditën e Premte, ora 16:00 në Zyren e Përmbaruesit Gjyqësor Privat Z. Medar KAJOLLI, në Adresën Rruga "Urani Pano", Pll.-1/3, Kat-2, Tiranë.

Per informacione mund të kontaktoni
 Nr.Tel.+355 66 20 333 03, ose në Adr.-email:medar.kajolli@gmail.com

Studimi, në 2 legjislatura 21 deputetë janë dënuar të paktën 1 herë për dhunë

Përplasja PD-PS, lista e plotë e deputetëve sherrxhinj në Kuvend

Listën e kryeson deputeti demokrat, Flamur Noka

Konflikti politik mes mazhorancës dhe opozitës është shqëruar shpesh herë edhe në Kuvendin e Shqipërisë. Rastet më të fundit ishin ato që u shënuan në dy seancat e fundit të sesionit të shkuar parlamentar, ku pjesë e përplasjeve u bënë edhe kryeministri, Edi Rama. Por natyrisht që ngjarjet më të rënda të këtyre dy legjislaturave të fundit janë padyshim ato kur deputetët socialistë, Armando Prenga dhe Arben Ndoka qëlluan me rrip dhe grushte, në dy raste të ndryshme, deputetin demokrat, Gent Strazimiri. Të gjëndur para këtij konfliktualiteti në rritje, drejtuesit e Kuvendit janë përpjekur që të ashpërsojnë masat penalizuese ndaj deputetëve "sherrxhinj" për t'i dhënë më shumë hapësirë debatit dhe fjalës se sa forcë dhe dhunës fizike. Kështu, në total në afro 5 vite Byroja e Kuvendit ka marrë masa për plotë 21 deputetë të ndryshëm, ku nuk mungojnë as deputetet femra. Listën e kryeson deputeti demokrat, Flamur Noka, i cili është bërë pjesë e një numri të lartë përplasjesh në sallën e Kuvendit të Shqipërisë dhe në komisionet parlamentare. Në të paktën 6 raste Byroja e Kuvendit e ka gjetur atë fajtor për gjenërimin e konflikteve apo edhe fjalorin e përdorur ndaj deputetëve të tjerë apo anëtarëve të kabinetit qeveritar. Shumicën e rasteve kur është përfshirë në konflikt, Noka i ka në dy vitet e fundit, 2017, 2018. Ndaj tij janë marrë disa masa të ndryshme dënimi, ku dominojnë ato me përfundim nga pjesëmarrja në seanca plenare dhe komisionet parlamentare deri në 10 ditë. Pas tij, i dyti në listën e deputetëve me më shumë dënime nga Byroja është deputeti, Gent Strazimiri. Ai është dënuar plot 4 herë nga Byroja, ndërsa në një pjesë të mirë të rasteve të tjera ka qenë edhe viktimë e dhunës. Edhe Strazimiri është dënuar kryesisht me 10 ditë përfundim nga pjesëmarrja në seancat plenare dhe në të paktën 1 rast tjetër vetëm me vërejtje. Pas tij me të njëjtin numër dënimesh vjen, Edi Paloka me plot 4 dënime. Në listën e deputetëve konfliktual është edhe ish-



Konflikti i fundit në Kuvend

RENDITJA E DEPUTETËVE KONFLIKTUAL

- Flamur Noka është dënuar 6 herë
- Gent Strazimiri është dënuar 4 herë
- Edi Paloka është dënuar 4 herë
- Sali Berisha është dënuar 3 herë
- Ervin Salianji është dënuar 2 herë
- Endri Hasa është dënuar 2 herë
- Kejdi Mehmetaj është dënuar 2 herë
- Endrit Brahimllari është dënuar 2 herë
- Klevis Balliu është dënuar 1 herë
- Monika Kryemadhi është dënuar 1 herë
- Bardh Spahia është dënuar 1 herë
- Bujar Çela është dënuar 1 herë
- Erjon Braçe është dënuar 1 herë
- Roland Keta është dënuar 1 herë
- Arben Ristani është dënuar 1 herë
- Bedri Hoxha është dënuar 1 herë
- Albina Dede është dënuar 1 herë
- Arben Noka është dënuar 1 herë
- Pjerin Ndreu është dënuar 1 herë
- Xhemal Qefallia është dënuar 1 herë
- Armando Prenga është dënuar 1 herë

Ndryshimet në qeveri, Shqipëria pa ministër të Jashtëm në Bruksel

Mosdekretimi i shkarkimit të ministrit të Jashtëm Ditmir Bushati dhe mosdekretimi pasuesit të tij, Genti Caka nga kreu i shtetit, ka krijuar ngërçin e parë në diplomacinë shqiptare. Në axhendën zyrtare të përfaqësueses së lartë për politikën e jashtme të BE, Frederica Mogherini, është planifikuar një takim me ministrin e Jashtëm të Shqipërisë, pasditën e 10 janarit. Por sipas Tv Klan burime zyrtare në Ministrinë e Jashtme nuk e konfirmojnë praninë e ministrit të enjten në takimin e planifikuar në Bruksel. Ministria nuk jep sqarime mbi arsyet, por mësohet se ato lidhen me largimin e Bushatit nga posti. Presidenti nuk e ka firmosur dekretin për shkarkimin e tij dhe ka sqaruar publikisht se mosdekretimi lidhet me rëndësinë që ka posti i ministrit të Jashtëm. Sipas tij, vendi nuk mund të mbetet për asnjë sekondë pa drejtuesin e këtij dikasteri që përfaqëson Shqipërinë në disa iniciativa shumë të rëndësishme.



kryeministri, Sali Berisha, me 3 dënime. Lista vazhdon me 4 deputetë të rinj të Kuvendit të Shqipërisë, Ervin Salianjin, Endri Hasën, Kejdi Mehmetajn dhe Endrit Brahimllari, të cilët janë dënuar me nga dy herë me përfundim nga pjesëmarrja

Hapja e negociatave, Ruçi nis lobimin me Presidencën rumune

Grazoç Ruçi ka nisur nga puna për lobimin me Presidencën rumune për çeljen e negociatave. Lidhur me këtë fakt, kryeparlamentari i ka dërguar një letër Presidentit të Dhomës Dragnea dhe të Senatit Tariceanu, ku kërkon mbështetjen e Rumanisë për procesin e hapjes së negociatave gjatë muajit qershor. "Shqipëria shpreh besimin e palëkundur se Rumania do të drejtojë me liderisht të suksesshëm Presidencën e saj të parë të Këshillit të BE. Shqipëria është angazhuar maksimalisht për përmirësimin e të gjitha kushteve për çeljen e negociatave të pranimit dhe një shtetshpirt të fuqishëm se Presidencia e Rumanisë, ashtu si deri tani, do të jetë në mbështetje të çeljes së negociatave në qershor 2019", shkrua Ruçi.

bërë gjuajta me çizme që ajo i bëri kryeministrit Edi Rama, gati 1 vit më parë, gjatë momentit kur në Kuvend u votua kryeprokurorja e re e përkohshme. Lista e deputetëve që janë dënuar vetëm 1 herë nga Byroja e Kuvendit është e gjatë, dhe ajo dominohet kryesisht nga deputetët e opozitës. Kështu, pjesë e saj janë deputetët: Klevis Balliu, Bardh Spahia, Bujar Çela, Erjon Braçe, Roland Keta, Arben Ristani, Bedri Hoxha, Albina Dede, Arben Noka, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefallia dhe Armando Prenga.

SHPLLJE ANKANDI

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përmbares gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 21.01.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i II-të për shitjen e pasurisë së paluajtshme, Arë me nr. 179/87, vol. 8, fq. 19 zk. 2326, në Kuman, Fier në pronësi të Z. Arben Refat Ramizi, me vlerë fillestare në ankand 420,0004(Katerqind e njëzet mijë)LEKë.

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

PRONAT VENDIMET

Amendimet në ligj përcaktojnë rregullat dhe afatet e reja për vendimet e pronave

Ndryshon procedura e kompensimit, ja vendimet që do ekzekutohen

Shumat deri në 10 mijë euro jepen menjëherë

Shteti shqiptar ka vendosur që të respektojë një më një të gjitha detyrimet që lindin nga vendimet e Gjykatës së Strasburgut për pronat. Në mënyrë që të mos penalizohet më në këtë drejtim nga institucionet europiane, mazhoranca ka miratuar gjatë muajit nëntor disa ndryshime të rëndësishme në ligjin "Për Avokatin e Shtetit", ku përveçse i jep këtij institucioni më shumë kompetenca në zbatimin e këtyre vendimeve, përcakton edhe disa procedura dhe afate të tjera në lidhje me ekzekutimin e tyre në favor të qytetarëve.

PROCEDURA

Kështu, sipas ligjit, vendimet e formës së prerë të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, për çdo çështje ku Republika e Shqipërisë është palë, janë të detyrueshme për zbatim dhe ekzekutohen sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj. Avokatura e Shtetit, në cilësinë e përfaqësuesit dhe mbrojtësit të interesave pasurorë të shtetit shqiptar pranë GJEDNJ-së është institucioni kompetent për nisjen e procedurave të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së. Me marrjen e vendimit të prerë, Avokatura e Shtetit brenda 10 ditëve pune përcjell vendimin përkatës për përkthim dhe certifikim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Drejtësisë, brenda 15 ditëve pune nga data e depozitimit të kërkesës së Avokaturës së Shtetit, dërgon vendimin e përkthyer dhe të certifikuar për publikim në Qendrën e Botimeve Zyrtare, si dhe pranë Avokaturës së Shtetit, me qëllim ndjekjen e procedurave të mëtejshme të ekzekutimit të vendimit të GJEDNJ-së. Brenda 5 ditëve pune nga dërgimi i vendimit të përkthyer nga Ministria e Drejtësisë, Avokatura e Shtetit paraqet kërkesën pranë kryeministrit për propozimin e projektvendimit të Këshillit të Ministrave, në lidhje me ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së. Projektvendimi duhet të përmbajë institucionet që ngarkohen me ekzekutimin e vendimit, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, llojin e masës që buron nga vendimi i GJEDNJ-së, mënyrën dhe afatet e ekzekutimit të saj, si dhe sanksionet në rast të moszekutimit. Vendimi i Këshillit të Ministrave miratohet brenda 30 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës së



Gjykata e Strasburgut

Flet Avokati i Shtetit: Ja si do veprohet me vendimet e pronave

Nga janari, të gjithë ata që kanë fituar një dëmshpërblim deri në 10 mijë euro pas gjyqeve kundër shtetit në Strasburg, do të marrin paratë menjëherë, pa kaluar në burokraci. Avokati i Shtetit, Artur Metani, duke folur për "A2" bëri të ditur se një nga risitë që përmban ligji i ndryshuar "Për Avokatin e Shtetit", është edhe ai i përcaktimit të detyrimit për ekzekutimin menjëherë të të gjitha vendimeve që kanë një vlerë të vogël financiare deri në 10 mijë euro. "Deri në masën 10 mijë euro janë drejtpërdrejt të ekzekutueshme. Pra, Avokati i Shtetit njofton Ministrinë e Financave, që ka detyrimin të bëjë publike listën e përfutuesve", - tha Metani. Ai theksoi se të gjitha këto lloje vendimesh do të përfshihen në një listë që do të hartohet dhe publikohet nga Ministria e Financave dhe çdo qytetar që ka fituar një të drejtë të tillë në Gjykatën e Strasburgut, duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e lekëve. "Pronat në listë duhet të dorëzojnë dokumentacionin brenda 30 ditësh, po nuk mundën, fondi ngurtësohet për 6 muaj, nëse nuk vjen informacioni pas kësaj periudhe, fondi i kalon buxhetit të shtetit", - shton Metani.



Avokaturës së Shtetit.

AFATI

Vendimet e GJEDNJ-së që kanë vendosur kompensimin e drejtë ekzekutohen nga institucionet përkatëse, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, brenda 3 muajve nga momenti kur vendimi i gjykatës merr formën e

prerë. Përjashtimisht, për detyrimet financiare deri në 10 000 euro, pagesa ekzekutohet në mënyrë të drejtpërdrejt nga ministria përgjegjëse për financat, pas njoftimit nga Avokatura e Shtetit. Brenda 10 ditëve pune nga miratimi i vendimit të Këshillit të Ministrave,

apo i marrjes së njoftimit nga Avokatura e Shtetit, ministria përgjegjëse për financat publikon listën e subjekteve përfituese dhe kërkesën për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm, për shpërndarjen e fondit përkatës. Në rastet kur pala e interesuar,

brenda 30 ditëve pune, nuk dorëzon dokumentacionin e kërkuar, ministria përgjegjëse për financat transferon pagesën në një llogari të veçantë depozitimi për kërkuesin, e cila qëndron e ngurtësuar derisa të përmbushen procedurat e parashikuara me ligj, por jo më shumë se 6 muaj nga data e depozitimit, me përjashtim të rasteve kur kërkuesi shpreh se ka një proces gjyqësor ose administrativ të hapur, i cili e pengon në respektimin e këtij afati. Në përfundim të këtij afati, fondet kalojnë në buxhetin e shtetit.

VENDIMET

Vendimet e GJEDNJ-së që kanë vendosur kompensimin e drejtë, ekzekutohen nga institucionet përkatëse, brenda 3 muajve nga momenti kur vendimi i gjykatës merr formën e prerë. Përjashtimisht, për detyrimet financiare deri në 10 000 euro, pagesa ekzekutohet në mënyrë të drejtpërdrejt nga ministria përgjegjëse për financat.

AFATET DHE PROCEDURAT

■ NENI 19/2

Fillimi i procedurave të ekzekutimit

1. Me marrjen e vendimit të prerë, Avokatura e Shtetit, brenda 10 ditëve pune, përcjell vendimin përkatës për përkthim dhe certifikim pranë Ministrisë së Drejtësisë.
2. Ministria e Drejtësisë, brenda 15 ditëve pune nga data e depozitimit të kërkesës së Avokaturës së Shtetit, sipas pikës 1, të këtij neni, dërgon vendimin e përkthyer dhe të certifikuar për publikim në Qendrën e Botimeve Zyrtare, si dhe pranë Avokaturës së Shtetit, me qëllim ndjekjen e procedurave të mëtejshme të ekzekutimit të vendimit të GJEDNJ-së.
3. Një kopje e vendimit original dhe një kopje e përkthyer dhe të certifikuar nga Ministria e Drejtësisë dërgohet nga Avokatura e Shtetit pranë Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe pranë institucioneve të tjera, për efekt të zbatimit të njehsuar të praktikës gjyqësore.
4. Brenda 5 ditëve pune nga dërgimi i vendimit të përkthyer nga Ministria e Drejtësisë, sipas pikës 2, të këtij neni, Avokatura e Shtetit paraqet kërkesën pranë Kryeministrit për propozimin e projektvendimit të Këshillit të Ministrave, në lidhje me ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, e cila duhet të përmbajë:
 - a) institucionet që ngarkohen me ekzekutimin e vendimit, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë;
 - b) llojin e masës që buron nga vendimi i GJEDNJ-së, apo masa të tjera të përshtatshme që duhet të ndërmerren nga autoritetet vendase, në rastet kur vendimi i GJEDNJ-së nuk përcakton në mënyrë të shprehur masat konkrete që duhet të merren nga Republika e Shqipërisë, në kuadër të shkeljeve të konstatuara;
 - c) mënyrën dhe afatet e ekzekutimit të saj;
 - d) sanksionet në rast të moszekutimit.
5. Vendimi i Këshillit të Ministrave miratohet brenda 30 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës së Avokaturës së Shtetit, sipas pikës 4 të këtij neni.

■ NENI 19/4

Afatet e ekzekutimit nga institucionet përgjegjëse

Vendimet e GJEDNJ-së që kanë vendosur kompensimin e drejtë, ekzekutohen nga institucionet përkatëse, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, brenda 3 muajve nga momenti kur vendimi i gjykatës merr formën e prerë.

■ NENI 19/5

Pagesa e dëmeve/kompensimit

1. Detyrimet financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ-së mbulojnë nga buxheti i shtetit, sipas përcaktimeve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së.
2. Përjashtimisht, për detyrimet financiare deri në 10 000 (dhjetë mijë) euro, pagesa ekzekutohet në mënyrë të drejtpërdrejt nga ministria përgjegjëse për financat, pas njoftimit nga Avokatura e Shtetit.
3. Në rast të moskryerjes së pagesës brenda afateve kohore, të parashikuara në nenin 19/4, të këtij ligji, mbi masën e detyrimeve përkatëse financiare paguhet interesi, sipas përcaktimeve në vendimin e GJEDNJ-së.
4. Brenda 10 ditëve pune nga miratimi i vendimit të Këshillit të Ministrave, apo i marrjes së njoftimit nga Avokatura e Shtetit, sipas rasti të parashikuar në pikën 2, të këtij neni, ministria përgjegjëse për financat publikon listën e subjekteve përfituese dhe kërkesën për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm, për shpërndarjen e fondit përkatës.
5. Në rastet kur pala e interesuar, brenda 30 ditëve pune, nuk dorëzon dokumentacionin e kërkuar, ministria përgjegjëse për financat transferon pagesën në një llogari të veçantë depozitimi për kërkuesin, e cila qëndron e ngurtësuar derisa të përmbushen procedurat e parashikuara me ligj, por jo më shumë se 6 muaj nga data e depozitimit, me përjashtim të rasteve kur kërkuesi shpreh se ka një proces gjyqësor ose administrativ të hapur, i cili e pengon në respektimin e këtij afati. Në përfundim të këtij afati, fondet kalojnë në buxhetin e shtetit.

TIRANË - Në orët e para të mëngjesit të 2 janarit është grabitur një argjendari në katin e parë të një qendre tregtare në autostradën Tiranë-Durrës. Burime të rezervuara nga uniformat blu bënë me dije për se katër persona të maskuar kanë shkuar pranë kësaj qendre tregtare, kanë lidhur punonjësit e shoqërisë private të sigurisë dhe kanë thyer derën e argjendarisë ku kanë mar-



Maskat grabitën 200 mijë euro bizhuteri në qendrën tregtare, policia fshehu ngjarjen

rë të gjitha bizhuteritë prej ari dhe gurë të çmuar që tregtoheshin në këtë biznes. Punonjësit e policisë janë njoftuar më vonë nga rojet e biznesit, ndërsa kanë bërë këqyrjen e vendngjarjes. Sipas informacioneve të siguruara, autorët e krimit kanë grabitur bizhu-

teri me vlerë mbi 200 mijë euro. Dyshohet se autorët janë pjesë e një bande që kanë kryer një sërë vjedhjesh të tjera në autostradën Tiranë-Durrës, por edhe në zonën e Fushë-Krujës. Për këtë ngjarje materialet janë çuar për ndjekje penale me akuzën e

shpërdorimit të detyrës punonjësit e shoqërisë private të sigurisë. Ndërkaq, kjo ngjarje është mbajtur e fshehur nga Policia e Shtetit, e cila nuk ka dhënë asnjë njoftim. "News 24" ka kontaktuar me njërin prej pronarëve të argjendarisë z. Abdulla Fra-

kulli, i cili tha se biznesi i tij është grabitur nga 4 persona dhe se po angazhohet edhe vete në zbulimin e identitetit të tyre. Kjo është hera e dytë që ky biznes grabitet. Në 24 dhjetor të vitit 2013 nga banda e babagjyshëve e drejtuar nga Ilir Kupa u grabit argjendaria "Gelosia" në një qendër tregtare, e cila ishte në pronësi të Ibrahim Çaushtit, i cili është ortak me masën 50% në argjendarinë ku ndodhi grabitja.

"Do kërkojmë miratimin e një fondi për familjen e dy motrave të masakuara"

Vrasja e dyfishtë në Ballsh, vëllai i viktimave pësoi vdekje klinike

Kryebashkiaku: Fëmijët e çiftit Çaushaj s'e dinë ç'ka ndodhur, i çuam në fshatin SOS

BALLSH

Një javë pas vrasjes së dyfishtë të ndodhur në Ballsh, ku 34-vjeçari Gazmend Musta masakroi me 28 goditje thike thikë bashkëshorten 31-vjeçare, Gentiana Çaushaj dhe kунatën 18-vjeçare, Merisa Çaushaj, janë zbardhur detaje të reja në lidhje me ngjarjen e rëndë. Mësohet se vëllai i dy viktimave kishte pësuar vdekje klinike pasi ishte ndjerë keq gjatë ceremonisë mortore. Ky fakt tragjik u bë i ditur nga kryebashkiaku i Ballshit, Agron Kapllanaj, i cili tregoi dramën e kësaj familje gjatë një prononcimi për mediat. "Kam qenë prezent në ceremoninë e varrimit dhe kam parë që ata kanë përjetuar një dramë të vërtetë. Vëllai i dy viktimave ka pësuar vdekje klinike gjatë varrimit dhe më pas u shoqërua urgjent në spital. Falë Zotit ai sot është mirë. Babai i tyre është në gjendje të rëndë, pasi ka qenë dhe i sëmurë. Ne jemi munduar që dhe do të vazhdojmë t'ju qëndrojmë afër, duke i ndihmuar edhe nga ana ekonomike që t'i heqim një pjesë të shpenzimeve të funeralit. Do i propozojmë Këshillit Bashkiak miratimin e një fondi specifik për këtë rast", tha kryebashkiaku. Ndërkaq, Kapllanaj tregoi edhe gjendjen, në të cilën ndodhen aktualisht dy fëmijët e çiftit të mitur, të cilët ishin në banesë gjatë kohës kur Gazmend Musta masakroi me thikë nënë e tyre dhe tezen. Kreu i bashkisë u shpreh se pak pas krimit, Gazmendi i kishte çuar fëmijët të dy në polici, ndërsa këta të fundit u trajtuan nga një punonjës social dhe psikolog dhe me pas u dërguan në fshatin SOS. Po ashtu kryebashkiaku tregon se bashkia ka mbuluar një pjesë të shpenzimeve të funeralit për dy motrat. "Ne jemi të gjithë në dijeni të ngjarjes së rëndë që ndodhi. Një ngjarje që na ka tronditur të gjithë mallakastriotët dhe mbarë opinionin. Është një ngjarje që nuk kishte ndodhur kurrë më parë në qytetin e Ballshit. Jemi të shokuar ne dhe jo më familjarët e viktimave të cilat



Vrasësi Gazmend Musta me familjen



Kryebashkiaku i Ballshit, Agron Kapllanaj

humbën jetën. Një dramë tjetër janë fëmijët, të cilët kanë përjetuar tmerrin e asaj që ndodhi, pasi babai aktin e kreu në sy të tyre, dhe ata kanë qenë të traumatizuar. Menjëherë pasi

ndodhi ngjarja, unë jam gjendur si kryetar bashkie aty, por edhe si qytetar në radhë të parë. Jemi interesuar për fëmijët, të cilët autori i kishte çuar në polici. Ne kemi çuar aty psikolog

dhe punonjësen sociale të Bashkisë të cilat janë marrë me fëmijët gjatë gjithë kohës. Vetë kam qëndruar pranë familjarëve të viktimave, që kanë qenë të shokuar dhe traumatizuar",

ka pohuar Agron Kapllanaj. Ndërkaq, ai sqaroi se "vetë familjarët e viktimave ishin duke shkuar tek vajza e tyre, madje i kishte ftuar autori për darrë. Atë natë fëmijët u strehuar tek një i afërm, dhe të nesërmen i kemi mbajtur në bashki në prezencën e punonjësve sociale dhe të psikologes dhe të policisë. Familjarët nuk ishin në gjendje që të na jepnin një përgjigje nëse mund t'i merrnin fëmijët. Na është dashur të flasim edhe me institucione të tjera shtetërore, me Qendrën e Emergjencave në Tiranë, që na u përgjigjën pozitivisht për t'i marrë atë natë dhe më pas ditën tjetër i transferuan në fshatin SOS. Ne përgatitëm dokumentacionet dhe fëmijët ishin shoqëruar nga psikolog dhe punonjës social. Në fshatin SOS kanë kushte më të mira dhe një staf të specializuar për trajtimin e tyre. Bashkia ka bërë të gjithë procedurën ligjore dhe njerëzore, ku vetë stafi i bashkisë ka shkuar dhe i ka blerë rroba fëmijëve dhe ushqime. Madje i kemi sjellë edhe shokë të klasës vajzës së madhe".



NJOFTIM I ADMINISTRATORIT TE SHOQERISE ANONIME KANTINA E PIJEVE " GJERGJ KASTRIOTI SKENDERBEU" SH.A

Njoftohen te gjithë aksioneret e Kantines se Pijeve "Gjegj Kastrioti Skenderbeu" sh.a se ne daten 06/02/2019, ora 12.00, ne seline shoqerise me adrese ne Rruga "Bajram Tusha" Lqj 14, Rrashbull, Dures organizohet Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme me kete rend dite:

1. Shtim aktiviteti te shoqerise per "Shtite me shumice e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez)"
2. Saktesim i adreses se Zyrave Qendrore te Selise ne Shqiperi ne ekstraktin e Regjistrit Tregtar, prane QKB- se.

Lutemi te merrni pjese ne mbledhjen e organizuar!

Dures, 08 Janar 2019

ADMINISTRATORI
Helidon KUSHI

Grabitja e bankës në Urën Vajgurore, kamerat s'punonin

Katër persona kanë sulmuar me eksploziv dhe kanë grabitur një bankë në Urën Vajgurore. Pak ditë pas ngjarjes, policia ka zbardhur detaje të reja në lidhje me këtë rast. Mësohet se banka ka nivel të ulët sigurie dhe sistem kamerash jo funksionale dhe se autorët janë larguar me një automjet në drejtim të Tiranës. Grabitja u realizua nëpërmjet shpërthimit të një sasive tritolit që u vu bankomatit jashtë bankës. Hetuesit e gështjes dhe sqaruan se sistemi i sigurisë në këtë bankë ka qenë shumë i dobët, pasi alarmi ka shpërthyer pas daljes së grabitësve nga ambientet e brendshme të bankës, ndërkohë që kamerat e sigurisë në bankë nuk punonin. Të njëjtat burime pohojnë se, pas sekuestrimit të kamerave të sigurisë së bizneseve përreth bankës është konstatuar se grabitësit kanë qenë 4 persona të maskuar e me kapuç në kokë, të cilët pasi kanë shpërthyer bankomatit dhe kanë marr lektë që ndodheshin aty, kanë hyrë për disa minuta edhe brenda në bankë dhe më pas janë larguar me një automjet pa targa. Grupi hetimor ka ndjekur kamerat e sigurisë përgjatë rrugës Urë Vajgurore-Lushnjë dhe aty, pas hyrjes së automjetit në autostradë në drejtim të Tiranës, policia ka humbur rrugëtimin e grabitësve. Sipas policisë, mendohet që personat të jenë nga Tirana dhe dyshohet se janë autor edhe të disa tentativave të grabitjeve të bankave të nivelit të dytë në Burrel e Mamurras, ku pasi ka rënë alarmi janë larguar, por nga dinamika e veprimeve, numri i personave dhe automjetit, që janë regjistruar nga kamerat e sigurisë në këto banka, dyshohet se janë të njëjtë grabitës. Ndërkohë, të njëjtat burime, pohojnë se nuk dihet saktë sesa para janë grabitur në këtë bankë, ku edhe pse në momentet e para u deklarua nga ana e punonjësve të bankës një shumë prej 5 milionë lekësh (të vjetra), mendohet që shuma grabitur të jetë shumë herë me e lartë.

ARSIMI PARAUNIVERSITAR BURSAT DHE MATURA

Këshilli i Ministrave: Përfshihen edhe kuotat financiare për ushqimin e konviktin

Zbardhen masat e bursave që do të marrin nxënësit e parauniversitarit

Vendimi: Kriteret që duhen përmbushur për të përfituar

Voltiza Duro

Sipas vendimit më të fundit të qeverisë, nxënësit e arsimit parauniversitar në vend mund të marrin bursë apo përfitime të tjera, nëse përmbushin kushtet e përcaktuara. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot kriteret ekonomike që duhet të plotësojë nxënësi si dhe masat e bursave që do të jepen për vitin mësimor 2018-2019. Gjithashtu, gazeta publikon edhe kuotat financiare sipas normave për ushqimin dhe veshmbathjen sipas kategorive përkatëse ku nxënësit bëjnë pjesë. "Nxënësit, të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore, publike të arsimit parauniversitar mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim, nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë", - theksohet në vendim.


KUSHTET
Për të përfituar bursë, nxënësit e parauniversitarit duhet të plotësojnë: kriteret ekonomike (bazuar në largësinë e shkollës nga banesa e nxënësit dhe gjendjen ekonomike); kriteret sipas rezultateve të arritura; kriteret jashtë kriterit ekonomik; si dhe sipas degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm, nxënësit, të cilët ndjekin me kohë të plotë arsimin profesional. Respektivisht, bursë mund të përfitojnë nxënësit, të cilët kanë përfituar statusin e jetimit; nxënësit, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë; nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik; nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë; nxënësit, fëmijë të personave që gëzojnë statusin e



invalidit, të cilët përfitojnë pension invaliditeti dhe nuk kanë të ardhura të tjera; nxënësit e komunitetit rom dhe egjiptian, të cilët regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional; nxënësit, të cilët janë identifikuar dhe trajtuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror. Gjithashtu, bursën e arsimit parauniversitar mund ta marrin edhe nxënësit, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, Forcave të Armatosura, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës; nxënëset (vajza), të cilat ndjekin drejtimet mësimore mekanikë, elektroteknikë, përpunim druri, gjeodezi, shërbim mjete transporti, termo-hidraulikë; nxënësit/fëmijët me një prind. Brenda 31 janarit të 2019-ës, njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore duhet t'u dërgojnë zyrtarisht drejtorive të shkollave profesionale për arsimin profesional dhe drejtorive rajonale arsimore/zyrave arsimore vendimet për dhënie bursave, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.

AFATI

Brenda 31 janarit të 2019-ës, njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore duhet t'u dërgojnë zyrtarisht drejtorive të shkollave profesionale për arsimin profesional dhe drejtorive rajonale arsimore/zyrave arsimore vendimet për dhënie bursave, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.



KUSHTET E PERFITIMIT TE BURSËS

Për të përfituar bursë, nxënësit e parauniversitarit duhet të plotësojnë: kriteret ekonomike (bazuar në largësinë e shkollës nga banesa e nxënësit dhe gjendjen ekonomike); kriteret sipas rezultateve të arritura; kriteret jashtë kriterit ekonomik; si dhe sipas degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm, nxënësit, të cilët ndjekin me kohë të plotë arsimin profesional.

Nr.	Përbërja familjare	Përfitojnë bursa	Përfitojnë gjysmë bursa	M e pagesë
	Për qytetin	<i>Me të ardhura mujore leke/faqe</i>	<i>Me të ardhura mujore leke/faqe</i>	<i>Me të ardhura mujore leke/faqe</i>
1	Për familjet me 2 persona	deri 3,200	3 200 – 4 600	Mbi 4 600
2	Për familjet me 3 persona	deri 3 100	3 100 – 4 500	Mbi 4 500
3	Për familjet me 4 persona	deri 3 000	3 000 – 4 400	Mbi 4 400
4	Për familjet me 5 persona	deri 2 900	2 900 – 4 300	Mbi 4 300
5	Për familjet me 6 persona	deri 2 800	2 800 – 4 200	Mbi 4 200
6	Për familjet me 7 persona	deri 2 700	2 700 – 4 100	Mbi 4 100
7	Për familjet me 8 persona	deri 2 600	2 600 – 4 000	Mbi 4 000

Pasqyra nr. 2 MASA E BURSËS PËR NXËNËSIT (VITI MËSIMOR 2018–2019) në lekë


Nr.	Kategorië e bursave sipas shkollave	Kuotat e bursës mujore në lekë			Financimi	
		Lekë për knollë ushqimi	Shpenzime vjetore	Totali i knollës	Financimi nga nxënësit/ prindër	Financimi nga shteti
1	Shkollat 9-vjecare dhe të mesme					
	a) Bursa	6 455	200	6 655	0	6 655
	b) Gjysmë bursa	6 455	200	6 655	3 327.5	3 327.5
	c) Me pagesë	6 455	200	6 655	6 655	0
2	Shkollat e Mjeshtrërisë Sportive e Arsimit Special					
	a) Bursa	7 017	200	7 217	0	7 217
	b) Gjysmë bursa	7 017	200	7 217	3 608.5	3 608.5
	c) Me pagesë	7 017	200	7 217	7 217	0
3	Për nxënësit jetimë	7 017	200	7 217	0	7 217

Pasqyra nr. 3 KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E

NXËNËSVE (VITI MËSIMOR 2018–2019)

Nr.	EMËRTIMI	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar në lekë	Vlera ditore në lekë
1	Bukë	gram	350-400	977	100	35
2	Makarona	gram	30	107	120	3.6
3	Oriz	gram	30	109	150	4.5
4	Sheqer	gram	40	157	100	4
5	Fasule	gram	30	93	200	6
6	Perime	gram	130	27	100	13
7	Fruta	gram	100	42	100	10
8	Vaj	gram	30	270	180	5.4
9	Gjalpë	gram	20	152	650	13
10	Mish	gram	70-80	115	750	52.5
11	Diathë	gram	25	40	600	15
12	Reçel	gram	20	93	250	5
13	Vezë	kokërr	1	42	12.5	12.5
14	Qumësht	gram	200	98	80	16
15	Patate	gram	200	170	40	8
16	Nënprodukte mishi	gram	30	100	400	12
	Kuota ditore			2712		125.5

Nr.	Emërtimi	Kuota financiare në lekë e veshmbathjes për një vit kalendarik
1	Për fëmijët e arsimit special	7 000 (shtatë mijë) lekë
2	Për nxënësit romë dhe egjiptianë	7 000 (shtatë mijë) lekë
3	Për jetimët	10 000 (dhjetë mijë) lekë



Udhëzimi i MASR: Seksioni dygjuhësh, italian dhe frëng, testimi në 24 maj

Zbardhen datat për 4 provimet e Maturës Shtetërore 2019

Si do të vlerësohet testi, procedura për mbetësit

Voltiza Duro

Nga data 7 deri në 24 qershor të këtij viti, do të zhvillohen provimet e Maturës Shtetërore 2019. Udhëzimi është publikuar ditën e djeshme në 'Fletoren Zyrtare' dhe ka hyrë në fuqi menjëherë. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot udhëzimin me datat përkatëse për secilin testim. Përkatësisht maturantët në 7 qershor do t'i nënshtrohen provimit të parë, atij të gjuhës së huaj; në 12 qershor do testojnë njohuritë në lëndën Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, ndërsa provimi i Matematikës do të zhvillohet në 17 qershor të 2019-së. Ndërkohë në udhëzim bëhet me dije për të gjithë maturantët e vitit mësimor 2018-2019 se provimi me zgjedhje do të mbahet në 24 qershor.



24

MAJ 2019
Testi i provimit "Gjuhë dhe letërsi italiane" (Lingua e literatura italiana) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe provimi zhvillohet më datë 24 maj 2019, në shkollat përkatëse.

KRITERET

2.1. Sipas kriterit ekonomik:

- Nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët vazhdojnë studimet në largësinë mbi 5 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre dhe që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- Nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët banojnë në zonat rurale që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km, të cilët akomodohen në konvikte publike dhe plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr.1.

2.2. Sipas rezultateve të arritura:

Nxënësit e arsimit profesional, të cilët kanë mbaruar vitin shkollor pararendës me të gjitha notat 10 (dhjeta).

2.3. Jashtë kriterit ekonomik:

- Nxënësit, të cilët kanë përfutur statusin e jetimit.
- Nxënësit, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë.
- Nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik.
- Nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë.
- Nxënësit, fëmijë të personave që gëzojnë statusin e invalidit, të cilët përfitojnë pension invaliditeti dhe nuk kanë të ardhura të tjera.
- Nxënësit e komunitetit rom dhe egjiptian, të cilët regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional.
- Nxënësit, të cilët janë identifikuar dhe trajtuar si viktima të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror.
- Nxënësit, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimt, Forcave të Armatosura, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.
- Nxënëset (vajza), të cilat ndjekin drejtimet mësimore mekanikë, elektroteknikë, përpunim druri, gjeodezi, shërbim mjete transporti, termo-hidraulikë.
- Nxënësit/fëmijët me një prind.

Në fillim të çdo viti shkollor, por jo më vonë se data 31 dhjetor 2018, për këto kategori nxënësishe, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe institucionet e përkujdesjes sociale rezidenciale publike duhet të dërgojnë në njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore përkatëse, ku ata ndjekin studimet, listën e nxënësve përfutues, sipas pikës 2.3, të këtij vendimi.

2.4. Sipas degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm, nxënësit, të cilët ndjekin me kohë të plotë arsimin profesional:

- në drejtimet mësimore: bujqësi, veterinar, pyje, ndërtim, peshkim, detari, gjeologji-miniera dhe shpim e shfrytëzimi i vendurimeve të natës dhe gazit;
- me vendbanim të përhershëm në zonat verilindore dhe juglindore të vendit: Dibër, Bulqizë, Mat, Kukës, Has, Tropojë, Pukë, Mirditë, Malësi e Madhe, Librazhd, Gramsh, Kolonjë, Përmet, Skrapar dhe Tepelenë.

5

QERSHOR, LISTA

Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të marrin nga shkollat listat e maturantëve mbetës të vitit shkollor 2018-2019, dhe brenda datës 5 qershor 2019, t'i pasqyrojnë ato në sistemin elektronik Matura online, sipas udhëzimit përkatës.

DATAT DHE TESTIMET

Lëndët dhe datat për provimet e Maturës Shtetërore 2019,

- a) Gjuhë e huaj: 7 qershor 2019;
- b) Gjuhë shqipe dhe letërsi: 12 qershor 2019;
- c) Matematikë: 17 qershor 2019;
- d) Provimi me zgjedhje: 24 qershor 2019.

Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2019:

- Fillojnë në orën 10:00.
- Provimet e detyruara dhe me zgjedhje zgjasin 2 orë e 30 minuta.
- Testet e provimeve të detyruara dhe me zgjedhje hartohen, administrohen dhe vlerësohen nga QSHA-ja.
- Testi për secilin nga provimet e detyruara dhe me zgjedhje vlerësohet me 60 pikë maksimale.
- Maturantët/kandidatët që rezultojnë mbetës në provimet e Maturës Shtetërore 2019, rrijapin provimet në sesionin e dytë.

dhe brenda datës 5 qershor 2019, do t'i pasqyrojnë ato në sistemin elektronik Matura online. "Listat e maturantëve mbetës të dërgohen në QSHA, në format të printuar dhe elektronik. Drejtoritë e shkollave njoftojnë maturantët mbetës, që të mos paraqiten në provimet e Maturës Shtetërore 2019, pa likuiduar më parë

provimet e klasës. Organizimi i konsultimeve me maturantët të kryhet sipas procedurave të përcaktuara në Urdrin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 121, datë 25.2.2011, "Për organizimin e konsultimeve në ndihmë të nxënësve maturantë", - thuhet në Fletoren Zyrtare.

SEKSIONI DYGJUHËSH

Ndërkohë, testi i provimit "Gjuhë dhe letërsi italiane" (Lingua e literatura italiana) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane do të përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe provimi do të zhvillohet më datë 24 maj 2019, në shkollat përkatëse. Ndërsa testi i provimit "Gjuhë frënge" (DELFB2 scolaire) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-franceze përgatitet nga ambasada franceze dhe provimi zhvillohet më datë 24 maj 2019, në shkollat përkatëse. "Tërheqja e testeve të provimeve të Maturës Shtetërore 2019 bëhet sipas grafikut të hartuar nga QSHA-ja dhe të miratuar nga MASR-ja. Përfaqësuesit e Postës Shqiptare tërheqin në QSHA materialet e provimit, një ditë para zhvillimit të provimit përkatës. Materialet e provimit paktohen për çdo qendër më vete. Shpërndarja dhe grumbullimi i materialeve të provimit bëhet mbështetur në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2019, në Republikën e Shqipërisë. Provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2019 zhvillohen në qendrat e provimeve të përcaktuara nga Komisioni i Maturës Shtetërore në institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar; mbështetur në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2019, në Republikën e Shqipërisë", - theksohet në udhëzim.

"U kthye pas 6 vitesh nga Anglia, ishte bërë shumë agresiv"

Myzafere Sela: Si mi vrau kunati vjehrrën dhe vjehrrin para syve

TIRANË

Historia e Myzafere Selës, 25 vjeçe, është bërë dje pjesë e emisionit "Me zemër të hapur" të moderatores Evis Ahmeti. 25-vjeçarja ka qenë prezente së bashku me 2 fëmijët e saj të vegjël, kur kunati ka ekzekutuar 2 prindërit e tij me automatik në Peshkopi. Në emision ajo ka rrefyer edhe momentet e masakrës, ku ajo burri dhe vajza e saj e vogël ishin dëshmitare. Myzafereja tha se Qemali filloi të bëhej agresiv për gjëra të vogla, në momentin që u kthye nga Anglia. "Kam vuajtur më shumë se 10 vjet. Martesa u lidh jo me dëshirë. Me vjehrrin nuk është se bënim muhabet, ai bënte muhabet vetëm me vjehrrën. Nuk e dinim që ishte i sëmurë. Kishte 6 vite pa ardhur. Atë ditë kur ka shkuar vjehrrin, më tha vjehrra, sot do vijë djali nga Anglia dhe ishte shumë e gëzuar. Kur Qemali ka zbritur me avion tjetër, vjehrrin ka qenë duke e pritur në aeroport. Ai ka marrë avi-



Myzafere Sela dje në emisionin "Me zemër të hapur"

on tjetër, ka marrë taksi për në Peshkopi. Në çehre ishte i zverdhur; në krah kishte një shenjë. Pyeti për mua, pyeti për fëmijët. Nga ora 10 e gjysmë vjen vjehrrin. Fletë gjumë deri në 12. Kur kemi qenë me atë nuk kemi dëgjuar asnjë debat. Ata kanë fjetur

në kat të parë, në në kat të dytë. Dëgjuam se kanë debatuar në orën 2 të natës, në nuk e kemi dëgjuar vetë, e kemi lexuar vetëm në media. I blejmë rroba, thotë çështje kjo bluzë e bardhë, bëhet agresiv. I thotë kunati do shoh fotot dhe bëhet agresiv. Marrim vjeh-

DEBATI

Kur Qemali ka zbritur me avion tjetër, vjehrrin ka qenë duke e pritur në aeroport. Ai ka marrë avion tjetër, ka marrë taksi për në Peshkopi. Në çehre ishte i zverdhur, në krah kishte një shenjë. Pyeti për mua, pyeti për fëmijët. Nga ora 10 e gjysmë vjen vjehrrin. Fletë gjumë, deri në 12 kur kemi qenë me atë nuk kemi dëgjuar asnjë debat. Ata kanë fjetur në kat të parë, në në kat të dytë. Dëgjuam se kanë debatuar në orën 2 të natës, në nuk e kemi dëgjuar vetë, e kemi lexuar vetëm në media.

rin se Qemali është bërë shumë agresiv. Sa ka ardhur vjehrrin e ka qëlluar, më pas ka qëlluar edhe vjehrrën. Ka marrë vajzën dhe e ka hipur në kat të dytë. Kam pasur marrëdhënie të shkëlqyer me vjehrrën. Pasi e qëlloi, e kthej vjehrrën, ishte mirë. Në praninë time vjen Qemali dhe e godet në zemër. Më ka thënë s'kam punë me ty Isha me dy kufo-ma. Për gjashtë vjet që ka ndenjur, Qemali ka qenë mirë. Në Angli e kanë kapur në kamp dhe e kanë kthyer. Ka qëndruar 2-3 muaj atje. Bashkëshorti ka marrë vajzën dhe është ngjitur në katin e dytë", u shpreh nusja në emision.



Urdhri i MD: Jo transferimit të policëve të burgjeve 45 km nga banimi

TIRANË - Viti 2019 sjell modalitete të reja për transferimin e punonjësve të burgjeve nga një institucion të vuajtjes së dënimit në një tjetër, duke shmangur në këtë mënyrë çdo mundësi për abuzim nga drejtuesit me transferimin e punonjësve. Ky fakt është mundësuar përmes një udhëzimi të firmosur nga ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj. Për herë të parë përcaktohet qartë se çdo punonjës i policisë së burgjeve nuk mund të transferohet në institucione të tjera, që janë në distanca të largëta nga vendbanimi i tij. Tashmë me rregullat e reja punonjësit e Policisë së Burgjeve, të rolit bazë dhe të mesëm, nuk mund të transferohen në një vend pune më larg se 45 km nga vendbanimi i tyre, me përjashtim të rastit kur japin pëlqimin me shkrim për këtë transferim. Po ashtu, me modalitetet e reja kërkohet që në çdo rast, transferimi të jetë i motivuar, me vlerësim të rezultateve individuale të punës, ndërkohë që i komunikohet edhe personit të transferuar. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, në çdo rast jep pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve për nevojë urgjente të shërbimit. Në udhëzim është përcaktuar qartë se kohëzgjatja e transferimit nuk mund të jetë më shumë se 6 muaj brenda një periudhe 2-vjeçare.

RREGULLI

Tashmë me rregullat e reja punonjësit e Policisë së Burgjeve, të rolit bazë dhe të mesëm, nuk mund të transferohen në një vend pune më larg se 45 km nga vendbanimi i tyre, me përjashtim të rastit kur japin pëlqimin me shkrim për këtë transferim. Po ashtu, me modalitetet e reja kërkohet që në çdo rast transferimi të jetë i motivuar.

INVITATION FOR BIDS (IFB)

Date: 09.01.2019
 Contract Identification N°: Ref: AL-8521/CW/NCB/2.1.03
 World Bank Loan/Credit N°: 8521- AL
 World Bank Loan/Credit Name: Citizen Centric Service Delivery Project

1. This Invitation for Bids follows the General Procurement Notice for this Project that appeared in Client Connection online, on August 28, 2015.

2. The Government of Albania has received a loan from the International Bank for Reconstruction and Development towards the cost of Citizen Centric Service Delivery Project and intends to apply part of the funds to cover eligible payments under the Contract for "Refurbishing and furniture of the Integrated Citizen Service Center of Kombinat". Ref: AL-8521/CW/NCB/2.01.03. Bidding is open to all bidders from eligible source countries as defined in the Guidelines: Procurement under IBRD Loans and IDA Credits.

3. The Agency for Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA) invites sealed bids from eligible bidders for Refurbishing and furniture of the Integrated Citizen Service Center of Kombinat. The main objective is the fulfillment of all required spaces, while achieving functional performance, fulfilling according norms and standards, finishing treatment, and required humidity, flow of light, ventilation and air-conditioning. The detailed project consists in the refurbishment/ reconstruction of the selected premise and its adaptation into a center for the provision of public services through the establishment and management of receiving counters for the citizens (front office) and integrated public service centers (one stop shop).

3. A complete set of Bidding Documents in English may be obtained at no cost by interested bidders on the submission of a written application or e-mail to the address given below. Further the Bidding Documents may also be downloaded from any of the following websites: www.adisa.gov.al
Project Management Unit

Bivd: Zhan d'Ark,
 Ish shtëpia e oficerave, Kati V-te
 Tirana, Albania
 e-mail: roland.jarashi@adisa.gov.al
info@adisa.gov.al
 and fiorentina.jorgji@adisa.gov.al

4. Bids shall be valid for a period of 60 days after Bid closing and must be accompanied by security of 5,000 EUR or an equivalent amount and shall be delivered
Project Management Unit
 Bivd: Zhan d'Ark,
 Ish shtëpia e oficerave,
 Kati V-te, Tirana, Albania
 Tel: +355666191381

on or before 06 February 2019, at 12.00, local time at which time they will be opened in the presence of the bidders who wish to attend.

Kartat e identitetit dhe pasaportat, ministri Sandër Lleshaj: Informohuni për datën e skadimit

TIRANË - Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, dje u ka bërë apel të gjithë qytetarëve që u skadojnë kartat e identitetit dhe pasaportat. Përmes një postimi në "Facebook", iu kujton atyre që të informohen për datën e skadimit të këtyre dokumenteve. Sipas tij, neglizhenca për të kryer detyrimin e pajisjes me dokumentet bazë të identifikimit mund të krijojë probleme për marrjen e shumë shërbimeve të rëndësishme, që nga udhëtimet jashtë vendit e të tjera.

REAGIMI I LLESHAJT

Pajisja me kartat e identitetit dhe pasaportat e reja për shumë qytetarë, të cilëve ato u skadojnë në gjysmën e parë të vitit 2019 është një prioritet i rëndësishëm. Qytetarët duhet të informohen për datën e skadimit të dokumenteve, pasi me të lidhet fati i shumë shërbimeve të rëndësishme. Zyrat e Gjendjes Civile janë



në dispozicion për të informuar dhe ndihmuar qytetarët. Neglizhenca për të kryer detyrimin e pajisjes me dokumentet bazë të identifikimit mund të krijojë probleme për marrjen e shumë shërbimeve të rëndësishme, që nga udhëtimet jashtë vendit e të tjera. Institucionet do të

kushtëzojnë dhënien e shërbimeve për personat që janë në muajt e fundit të vlefshmërisë së dokumenteve, me paraqitjen e vërtetimeve mbi aplikimin për dokumentin e ri. Ndaj lutemi, verifikoni dokumentet e identitetit dhe mos harroni t'i bëni shërbimin e duhur vetes!

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

A. PASURIA nr. 281 / 10, e lojit "Arë", zona kadastrale 2631, volumni 18, faqe 15, sipërfaqe 1.000 m2, adresë: Mbojje-Korçë, në pronësi të KOÇO LENA, Çmimi 2.168.144 Lekë.

B. PASURIA nr. 187 / 20, e lojit "Arë", zona kadastrale 2631, volumni 11, faqe 250, sipërfaqe 1.500 m2, adresë: Mbojje-Korçë, në pronësi të KOÇO LENA, Çmimi 739.140 Lekë.

Data e zhvillimit të ankandit do jetë 14.01.2019.
 CEL: 0684026666 / 0693262866.

Mbërrin në Berat trupi i pajetë i 29-vjeçares, sot ceremonia e varrimit

I dashuri i shqiptares së vrarë: Një javë para se të vritej i propozova martesë

30-vjeçari afgan: Angjelinën e keqtrajtonte edhe xhaxhai, më kërcënuan edhe mua

BERAT

Pak ditë pas vrasjes makabre në Korfuz të Greqisë, ka mbërritur dhe në Berat trupi i pajetë i Angelina Petros. Mësohet se nëna e 29-vjeçares, Xhezmije Stoçeni kishte shkuar në Korfuz së bashku me të afërm të saj për të tërhequr trupin e së bijës, e cila u masakrua për vdekje dhe u gëzoi në oborrin e shtëpisë nga i ati, Aleko Petro. Nëna e viktimës kishte 13 vite pa e parë të bijën, pasi Angelina në moshën 16-vjeçare u largua nga Berati dhe shkoi tek i ati i saj në Korfuz për një jetë më të mirë. Ceremonia e varrimit të së resë do të bëhet ditën e sotme në orën 11:00. Ndërkaq, mediat greke kanë zbardhur detaje të reja në lidhje me ngjarjen që tronditi opinionin publik në Greqi dhe jo vetëm. Ka qenë i dashuri afgan i 29-vjeçares shqiptare që ka deklaruar se me Angjelinën kishin planifikuar martesë. Duke folur për televizionin grek "Skaï", 30-vjeçari është shprehur se një javë para se të ndodhte ngjarja e rëndë, ai i kishte propozuar për martesë 29-vjeçares shqiptare. "Isha si burri i saj. I kisha propozuar për martesë një javë para krimit. Fatkeqësisht nuk mundëm", tha ai duke përmendur edhe disa kërcënime që Angelina kishte marrë nga babai i saj, por edhe dhunës fizike të ushtruar nga ai, madje edhe nga xhaxhai. "Një herë e qëlloni edhe xhaxhai në shtëpinë e babait të saj. Më kërcënuan edhe mua që të ndaheshim, por dashuria jonë ishte e madhe. Ajo vajzë kishte përballuar një tirani të madhe", është shprehur 30-vjeçari afgan. Angelina Petro u godit disa herë për vdekje me shufër hekurri mbremënjë e 2 janarit nga ba-



29-vjeçarja e vrarë, Angelina Petro (arti) Aleko Petro



Viktima me të dashurin afgan

bai i saj, Aleko Petro. Ngjarja e rëndë ndodhi në Korfuz të Greqisë në banesën e të atit. 52-vjeçari Aleko Petro ishte kundër lidhjes së vajzës së tij me emigrantin afgan, që ishte birësuar nga një familje greke. Sipas dëshmitave të pasqyruara në mediat e vendit fqinj, Anxhelina dhe i dashuri i saj bashkëjetonin prej 13 muajsh. Aleko Petro ka pranuar krimin dhe ka deklaruar se është penduar për atë që ka bërë. Madje, ai ka kërkuar që dënimi i tij të jetë varja në një shesh publik si shembull për të tjerët. Tri ditë më parë, i riu afgan ka pohuar në polici se me Angjelinën ka qenë

në lidhje dashurie prej 13 muajsh. Mësohet se Angjelinë donte të shkonte të vizitonte babain e saj për shkak të festave. Ndërsa i dashuri i saj nuk ishte dakord që ajo të shkonte, pasi nuk kishte raporte të mira me të atin. Në orën 20:45, i dashuri afgan kontaktoi 29-vjeçaren për t'u siguruar që kishte mbërritur tek banesa e babait të saj. Kjo ishte telefonata e parë që mesa duket revoltoi Aleko Petron dhe nxiti debatin mes tyre, pasi 52-vjeçari ishte kundër lidhjes së vajzës së tij me emigrantin afgan. Në orën 21:23, i dashuri telefonoi përsëri Angjelinën. Biseda mes tyre zg-

MJEKJA LIGJORE
"29-vjeçarja është goditur të paktën 7 herë në kokë me shufër hekurri. Nga këto goditje vihet re tension, urrejtje. Duket se viktima ka ngritur duart për të mbrojtur fytyrën, vazhdonte ta qëllonte edhe në duar. Pastaj ky prind pastroi shtëpinë nga gjakrat, fshehu sendet personale dhe e varrosi në kopsht. Si mundet një prind të jetë kaq gjaktohtë para një akti të tillë? Kjo vrasje më ka lënë pa fjalë, nuk ishte thjesht një incident, ishte shumë e egër, shumë brutale", ka thënë mjekja ligjore, Hrisavggi Kushi për median greke.

jati 26 sekonda. E pyeti si po kalonte, kurse 29-vjeçarja shqiptare i tha se ndodhej në shtëpinë e babait, ndërsa nga zhurmat në sfond kuptoi që

Angelina po ngjiste disa shkallë. Më pas, vajza shqiptare i kërkoi të dashurit që të mbyllte telefonin, pasi po i bërtiste babai i saj, Aleko.

Vrau ish-gruan gjyqtare, shtyhet gjyqi për Fadil Kasemin

TIRANË - Në një kohë kur sot ishte caktuar gjyqi për Fadil Kasemin, i cili akuzohet për vrasjen e ish-bashkëshortes së tij gjyqtare, ai është shtyrë për një tjetër ditë. Mësohet se pala mbrojtëse ka kërkuar më shumë kohë për të këqyruar dosjen. Më 27 dhjetor Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe pretencën për Kasemin, i cili vrau gjyqtaren Fildex Hafizi. Prokuroria kërkoi burgim të përjetshëm për Kasemin, dënim që duhet ta vuajë në një burg të sigurisë së lartë. Kujtojmë se gjyqtarja Fildex Hafizi u vra më 31 gusht 2017 nga ish-bashkëshorti i saj, 39-vjeçarja u qëllua me 2 plumbë pistolette brenda makinës së saj nga Fadil Kasemi. Ky duket se ishte fundi i një kronike të parajamëruar, pasi kërcënimet ndaj saj kishin qenë të vazhduara. Shkak për këtë situatë ishte divorci mes Hafizit dhe Kasemit. Edhe pse kishte marrë një urdhër mbrojtjeje, gjyqtarja kërcënohej vazhdimisht ish-bashkëshorti.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

NJOFTIM PËR EKSPERTË DHE SPECIALISTË TË PAVARUR

Në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe Vendimit të KPP-së nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", KPP shpall konkurrimin për plotësimin e listës vjetore të Ekspertëve dhe Specialistëve të Pavarur në fushat: Ekspert vlerësimi i pasurive të paluajtshme; ekspert kontabël i regjistruar; inxhinier elektronik/informatik; inxhinier mekanik; inxhinier hidrologjik; inxhinier elektrik; inxhinier gjeologji-minierash; inxhinier mjedisi; inxhinier ndërtimi; inxhinier tekstil; kimist; specialist në farmaceutikë.

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat:

1. Të ketë mbaruar arsimin e lartë në fushën ku ai do të konkurrojë.
2. Të ketë licensë në fushat ku ligji parashikon pajisjen me të.

Pagesa dhe shpenzimet e ekspertëve apo specialistëve të pavarur do të bëhet me parapagim nga pala ankimese.

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 08 Shkurt 2019 në selinë e Komisionit të Prokurimit Publik këto dokumenta: kërkesën për aplikim, CV-në, fotokopje të diplomës dhe librezës së notave, fotokopje të licensës si ekspert, të librezës së punës, vërtetimin e gjendjes gjyqësore, fotokopje të kartës së identitetit, numër kontakti, si dhe adresën e plotë të vendbanimit

Vjen letërporosia: Gjyqtari Thanza, i dënuar për vjedhje në Itali

TIRANË - Ish-gjyqtari Admir Thanza rezultoi i dënuar për vjedhje në Itali. Ky fakt është konfirmuar nga letërporosia e ardhur nga shteti fqinj për llogari të Thanzës. Edhe Thanza e ka pranuar kur është pyetur në prokurori këtë fakt. ONM zbuloi gjatë vetëgjyqimit të formularit të dekriminalizimit. Në formularin e dekriminalizimit, Thanza nuk kishte deklaruar dënimin. Admir Thanza ishte dënuar në Itali me 40 ditë burg për vjedhje në bashkëpunim në vitin 1999, kohë në të cilën ishte dhe gjyqtar në Gjykatën e Shkodrës. Than-



za nuk e kishte deklaruar në formularin këtë dënim, por për rastin, përpara anëtarëve të KPP-së tha se vjedhjen e kishte kryer kunata e tij, por ai e mori përsipër për të ndihmuar nipin e tij të sëmurë që po kurohej në Itali, pasi vuante nga një sëmundje e rëndë.

Takimi në Bruksel, Veseli: Refuzimi i dialogut me fqinjin nuk është alternativë

Mogherini, kosovarëve: Hiqni taksën me Serbinë

"Arritja e marrëveshjes gjithëpërfshirëse, ligjërish obliguese"

Bekim Bislimi

Në Bruksel ka përfunduar takimi ndërmjet delegacionit shtetëror të Kosovës për dialog me Serbinë dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politika të Jashtme dhe Politika të Sigurisë, Federica Mogherini. Pas takimit, Mogherini tha se është e domosdoshme arritja e një marrëveshjeje për normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Ky takim ishte një mundësi për të biseduar me përfaqësuesit e Kosovës lidhur me dialogun. Në këtë kontekst, Mogherini ka ritheksuar urgjencën për shfuqizimin e tarifës doganore, të vendosur nga Qeveria e Kosovës", thuhet në deklaratën e lëshuar nga zyra e Mogherinit. "Arritja e marrëveshjes gjithëpërfshirëse, ligjërish obliguese për normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, në kuadër të dialogut kërkon një klimë që kontribuon në marrëdhënie të mira fqinjësore, ku marrëveshjet e arritura më herët duhet të respektohen e zbatohen dhe veprimet e deklaratat që nuk janë në interes të përgjithshëm dhe objektivat strategjike të rajonit duhet të shmangen", theksohet në deklaratë. Ndërkaq, dy bashkëdrejtuesit e delegacionit shtetëror të Kosovës, Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti kanë theksuar se në takim kanë prezantuar rezolutën dhe Ligjin për dialogun, si dhe i kanë sqaruar zonjës Mogherini rolin e këtij delegacioni dhe gatishmërinë për të diskutuar për të gjitha temat e hapura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të cilat do të çonin deri të një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, me kushtin parësor, njohjen reciproke. Shpend Ahmeti ka theksuar se sipas zonjës Mogherini, duhet të punohet me një orar më të ngjeshur në gjysmën e parë të këtij viti, për të parë nëse do të mund të arrihet një marrëveshje. "Sipas Mogherinit, për BE-në çdo marrëveshjeje që është e pranueshme për të dyja palët - por marrëveshjeje, e cila i përfaqëson vlerat e Bashkimit Evropian - është e pranueshme edhe për ta. Pra, nuk mund dhe nuk do të kemi shtet etnikisht të pastra, sepse ajo nuk është vlerë e BE-së. Nuk mund të kemi kufij që ndajnë etnitë në vija të tilla", theksoi Ahmeti. Ai ka shtuar se tashmë i kanë sqaruar



Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Politika të Jashtme dhe Politika të Sigurisë, Federica Mogherini.

Mogherinit që delegacioni shtetëror nuk është në mbështetje të dikujt që është në mbështetje të delegacionit dhe se delegacioni shtetëror ka mandat nga Kuvendi. Gjithashtu, në takim me Mogherinën është ngritur edhe çështja e taksës për mallrat nga Serbia, për të cilën Beogradi ka shprehur qëndrimin se pa heqjen e tarifës nuk do të ketë vazhdim të dialogut. Fatmir Limaj, bashkëkryesues i delegacionit shtetëror të Kos-

ovës, ka theksuar se zonjës Mogherini i janë bërë të qarta politikat obstruksioniste që i ka ndërmarrë Serbia ndaj Kosovës. "Ne e thamë aty se duhet të hiqen arsyet për të cilat ka ardhur taksat. Serbia duhet t'i pushojë të gjitha arsyet pse ne e kemi ngritur taksën. Ka shumë kushte që Serbia duhet të plotësojë që të tërhiqet taksat. Kjo nuk është e njëanshme", tha ai. "Nën kushte të tilla, ne kemi 10 vjet tashmë që jetojmë me Serbinë dhe

askush nuk është lodhur për këtë punë. Tani jemi në momentin ku të gjithë duhet ta krijojmë klimën për dialog dhe jo vetëm Kosova. Ne jemi të gatshëm që të bëjmë hapin edhe për çështjen e taksave. Me një marrëveshje gjithëpërfshirëse nuk do të ketë nevojë për taksë", theksoi Limaj. Ndërkaq, zëvendës kryeministri, njëherësh ministri i Jashtëm i Kosovës, Behgjet Pacolli është shprehur se dialogu ndërmjet Kosovës dhe

EKIPI NEGOCIATOR

Dy bashkëdrejtuesit e delegacionit shtetëror të Kosovës, Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti kanë theksuar se në takim kanë prezantuar rezolutën dhe Ligjin për dialogun, si dhe i kanë sqaruar zonjës Mogherini rolin e këtij delegacioni dhe gatishmërinë për të diskutuar për të gjitha temat e hapura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të cilat do të çonin deri të një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, me kushtin parësor, njohjen reciproke.

Serbisë duhet të çojë në një hje reciproke, anëtarësimin e vendit në BE, NATO dhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara. "Zyra e Bashkimit Evropian për çështje të jashtme ka ftuar delegacionin nga Kosova të zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës më 15 dhjetor, për konsultime në Bruksel më 8 janar. Ekipi gjithashtu do të pritet nga Përfaqësuesja e Lartë e BE-së, Federica Mogherini. Konsultimet janë një mundësi për të diskutuar me përfaqësuesit e Kosovës

në dialog për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, që lehtësohet nga BE-ja. Dialogu në nivelin e lartë bëhet ndërmjet dy presidentëve dhe kjo nuk ndryshon", ka thënë Kocijançiq për Radion Evropa e Lirë. Ndërkohë që ekipi negociator i Kosovës ka nisur takimin me zyrtarët e BE-së në Bruksel, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, përmes një shkrimi në rrjetin social "Facebook" ka shprehur mbështetjen e tij për delegacionin e Kosovës. Ai ka thënë se "ky delegacion ka mandat të plotë legal dhe legjitim nga Kuvendi i Kosovës. Kosova është e gatshme dhe e vendosur për dialog me Serbinë. Vendimet që do të merren do të jenë në respekt të plotë të shtetit të pavarur e sovran të Kosovës dhe në koordinim me partnerët tanë perëndimorë, si dhe të gjithë mbështetësit e shtetit tonë. Refuzimi i dialogut nuk është alternativë, as zgjidhje. Për më tepër do të ishte një favorizim i Serbisë në arenën ndërkombëtare", ka shkruar Veseli në "Facebook". Ai ka shtuar se Kosova hyn në dialog me qëllim të qarta: njohje e shtetit të Kosovës nga ana e Serbisë dhe anëtarësimin në OKB, si dhe që nuk do të lejohet asnjë rezultat që dobeson integritetin e shtetit të Kosovës.

LDK: Ekipi negociator nuk ka bazë kushtetuese

Besian Mustafa, zëdhënësi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në një konferencë për media ka thënë se ekipi negociator i Kosovës në dialog me Serbinë nuk ka asnjë bazë kushtetuese dhe është mandatar me vetëm 59 vota në Kuvendin e Kosovës. "E konsiderojmë si një grup negociator pa legjitimitet sa i përket aspektit kushtetues. Në anën tjetër, kemi deklaratat e Komisionit Evropian ose Zyrës së Komisionerit Mogherini, të cilët thonë që 'ne do të takohemi me grupin negociator, por në fakt diskutimet vendim-marrëse vazhdojnë në nivelin e presidentëve'. Kjo e vë në pikëpyetje edhe vetë ekzistencën e këtij grupi negociator, në rast se vendimmarrja do të merret në nivelin e presidentëve", ka thënë Mustafa. Ai ka shtuar se Qeveria e Kosovës po e "shëtit" përgjegjësinë e negociatave me Serbinë nga kryeministri të presi-



denti, e më pas tek ekipi negociator, që sipas tij nuk ka bazë kushtetuese. Mustafa ka theksuar se LDK-ja është për një dialog, ku Serbia e njeh Kosovën të pavarur dhe jo për një dialog ku Serbia vendos mbi shtetin e Kosovës dhe kufijtë e saj. Në anën tjetër, bashkëkryesuesit e ekipit negociator para udhëtimit për në Bruksel u kanë thënë medieve se takimi i paralajmëruar për datën 8 janar është më tepër i natyrës konsultative. Siç është thënë, ky

takim ka për qëllim njohimin e Brukselit zyrtar me delegacionin e Kosovës, përkushtimin dhe qëndrimin për dialogun, si dhe shpërfaqjen e ideve për platformën e dialogut. Gjithashtu, bashkëkryesuesit e ekipit negociator kanë theksuar edhe pritjet që kanë nga Brukseli zyrtar, si lehtësues i dialogut Kosovë-Serbi, që të paraqesë pikëpamjet mbi pjesën përfundimtare të dialogut ndërmjet dy

Presidenti Thaçi: Kosova, e vendosur për marrëveshje përfundimtare me Serbinë

Formimi i ekipit negociator ka ardhur si rezultat i synimit të Qeverisë së Kosovës që ta zbehë rolin udhëheqës të Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, në dialogun me Serbinë, pas idesë së këtij të fundit për "korrigjim" të kufirit, si mënyrë e arritjes së një marrëveshjeje paqësore me Serbinë. Kjo ide është kundërshtuar fuqishëm nga kryeministri Ramush Haradinaj, por edhe nga partitë në opozitë. Më 15 dhjetor 2018, Kuvendi i Kosovës pati miratuar një rezolutë për dialogun me Serbinë. Ndërkaq, më 24 dhjetor 2018, Qeveria e Kosovës ka miratuar projektligjin për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Serbisë, të cilin pritet ta dërgojë për miratim në Kuvend. Por, dy partitë e mëdha opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje nuk i kanë dhënë mbështetjen as rezolutës për dialogun e as ekipit negociator.



VIP

Suplement
Pages

Emërkurë 9 Janar 2019

GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- "Komodim i ri", Bregu shfaqet në shtëpinë moderne në Sarajevë
- Julian Deda ironizon Ramën, anëtari i PD publikon foto nga dushi
- Putin qëllon me top nga fortesa e Shën Peterburgut
- Ironia e zv.ministrit të Ramës: Protestë kundër ndryshimit të motit

"Plakat në sulm!", reagon Aurela Gaçe: Më puth b**** time labe



"Jukeni zot m**in tim!", Enca reagon keq pas fotos që i publikojnë nga WC-ja



Rrëfehët studentja sipërmarrëse shqiptare: Kam qenë dhe jam një personalitet që çohet dhe flet nëse ka diku padrejtësi

Arbela Statovci: Do jap kontributin tim për të ardhmen e përbashkët

"Të rinjtë duhet të marrin pjesë në jetë, sepse vetëm nëse bashkëpunojmë jemi të fortë"



Rrëfhet studentja sipërmarrëse shqiptare: Kam qenë dhe jam një personalitet që çohet dhe flet nëse ka diku padrejtësi

Kandidon për deputete në Cyrih të Zvicrës, **Arbela Statovci**: Dua të jap kontributin tim për të ardhmen e përbashkët


"Të rinjtë duhet të marrin pjesë në jetë, sepse vetëm nëse bashkëpunojmë jemi të fortë"

Pamela Alija

Çdo vit e më tepër dëgjojmë lajme të reja lidhur me shqiptarë, të cilët angazhohen në fusha të ndryshme nëpër botë, duke përfaqësuar veten e tyre, familjen si dhe vendin nga i cili vijnë. Por së fundmi janë shtuar edhe rastet kur të rinjtë me prejardhje shqiptare po triumfojnë në fushat politike të shteteve më të zhvilluara të botës. I tillë është edhe rasti i vajzës me prejardhje nga Prishtina. E rritur në Zvicër, edhe pse ende një studente, ajo ka një biznes të sajën si dhe kandidon për deputete në Zyrih të Zvicrës. Në një intervistë ekskluzive për "VIP Pages" të "Gazeta Shqiptare", Arbela në një rrëfim frymëzues ka folur lidhur me rrugëtimin e saj si dhe angazhimet e shumta në fusha të ndryshme. "Kam qenë edhe jam një personalitet që çohet dhe flet nëse ka diku padrejtësi, ose edhe punë, të gjej ndonjë zgjidhje. Kështu që ka qenë vetëm një çështje kohe kur do mundesha të angazhohesha edhe në politikë", ka thënë ndër të tjera Arbela. Ajo gjithashtu ka folur edhe për rrugën e vështirë që familja e saj ka kaluar para se të emigronte në Zvicër, ku rrefen edhe faktin e dënimit me burg të të atit në vitet '80, duke u përpjekur të mbrojnë vendin e tij, traditat dhe gjuhën. Si përfundim, Arbela ka një mesazh edhe për të rinjtë: "Është shumë e rëndësishme të kontribuojmë në atë vend që jetojmë, që të jetë pjesë e diçkaje më të madhe. Që merr përgjegjësinë për veten, për fqinj, për rini, e cila është e ardhmja jonë. Sa më shumë që kontribuojmë, aq më shumë mundemi të arrijmë! Dhe mos harroni se ju shpërblehet, nga një vend, nga një shoqëri, nga një parti, si në rastin tim, në FDP. Edhe ajo që është më e rëndësishme: Mundi të bën dallimin për një person, një familje, sidomos në Zvicër, që kemi demokracinë direkte dhe zëri nënë ka vlerë".

Për herë të parë një shqiptare konkurron në parlamentin e Zyrihut. Si ka qenë rrugëtimi juaj deri këtu?

Unë kam vite që jam përkrahëse e Partisë Liberale. Në moshën 20-vjeçare jam bërë pjesë e partisë, por nuk kam qenë shumë aktive. Ka qenë koha e gjimnazit, kështu që nuk kam



pasur shumë kohë për angazhim në politikë. Gjatë studimeve për Bachelor në shkencë të komunikimit kam punuar në radio si gazetare për një vit. Gjatë kësaj kohe jam ballafaquar me tema të ndryshme politike dhe e kam kuptuar që jam pjesë e një shoqërie, e vendit ku jetoj dhe dua të jap kontributin tim për të ardhmen e përbashkët. Kështu kam vendosur që pasi t'i përfundoj studimet, do të jem më aktive për komunën, për kantonin dhe për shtetin zviceran, me motivin më të madh si përfaqësuese e femrave, të cilat ende nuk përfaqësohen si duhet dhe e shqiptarëve, sidomos e gjeneratës sime. Jam pranuar në Bordin e FDP-së në komunë, e cila më ka motivuar edhe më ka propozuar të konkurroj për deputete në Parlamentin e Zurichut. Kam gjetur veten në partinë e FDP, që i ndan vlerat e mia personale si vetëvendosjen, vetëpërgjegjësinë, lirinë personale dhe kolektive edhe angazhimin për bashkësinë. Në Zvicër kemi shumë persona të cilët janë në gjeneratën e 2-të edhe kanë hapur biznese të ndryshme, për cilat FDP-ja angazhohet që të zvogëlohen pengesat burokratike dhe të krijojnë kushte optimale për kompanitë reja, në mënyrë që kantoni i Zyrihut të mbetet tërheqës për ndërmarrësit dhe inovacionet. Si një ndërmarrëse, arsimi, shkencë dhe inovacioni janë shumë të rëndësishme për mua. Suksesi i Zvicrës bazohet kryesisht në një sistem të shkëlqyeshëm arsimor. Vendet e huaja na

lakmojnë për arsimin tonë fleksibël dhe të orientuar drejt të ardhmes. Është e rëndësishme të vlerësojmë dhe të zhvillojmë këtë.

Si lindi dëshira për të qenë pjesë e politikës zvicerane?

Zvicra i ka sjellë mundësinë familjes dhe mua që të krijojmë një jetë më të mirë, më të suksesshme. Është vendi ku jam rritur, jam shkolluar edhe ku kam krijuar shoqërinë private dhe biznesin dhe e kam kuptuar që jam pjesë e një shoqërie, e vendit ku jetoj dhe dua të jap kontributin tim për të ardhmen e përbashkët. Është edhe trashëgimia ime, jam



e bindur. Katragyshi im, Mulla Emin Statovci, ka qenë shumë përparimtar kur e ka hapur shkollën e parë edhe e ka mbrojtur alfabetin shqip. Dr. Ejup Statovci ka qenë doktor shkence në fushën juridike ku ka dhënë ligjratë në universitetin anglez,

Cambridge. Ka qenë profesor edhe rektor i universitetit të Prishtinës. Janë disa shenja që kollën e parë edhe e ka mbrojtur alfabetin shqip. Dr. Ejup Statovci ka qenë doktor shkence në fushën juridike ku ka dhënë ligjratë në universitetin anglez, Cambridge. Ka qenë profesor edhe rektor i universitetit të Prishtinës. Janë disa shenja që kollën e parë edhe e ka mbrojtur alfabetin shqip. Dr. Ejup Statovci ka qenë doktor shkence në fushën juridike ku ka dhënë ligjratë në universitetin anglez,

si dhe atë politike për një të ardhmen sa më të mirë. Babi im ka qenë i arrestuar në vitet '80 për atë që ka demonstruar të mbrojtë vendin e tij, traditat dhe gjuhën. Nuk mundem ta kuptoj për atë që është dënuar, por kuptoj dëshirën e babit që ka pasur për të kontribuar me angazhim për vendin që do edhe që jeton. Është e tillë edhe tek unë. Unë e konsideroj veten si zvicerane dhe si shqiptare, kështu që kam detyrën si banore e këtij vendi, të angazhohem për më të mirën.

Kush ka ndikuar tek ju apo ju ka nxitur për të ndjekur këtë rrugëtim?

Vetvetja. Kam qenë edhe jam një personalitet që çohet edhe flet nëse ka diku padrejtësi, ose edhe punë, të gjej ndonjë zgjidhje. Kështu që ka qenë vetëm çështje kohe kur do mundesha të angazhohesha edhe në politikë. Ajo që nuk më pëlqen aspak është nëse ankohet dikush, por nuk do të gjej një zgjidhje, por vetëm ankohet pa dëshirë të marrë përsipër





përgjegjës. Është shumë e lehtë të ankohesh. Kështu që kam qëndruar tek partia FDP optimale, duke qenë se i përkrah të gjithë ata sipërmarrësit ose personat e angazhuar, nëse arrijnë diçka edhe marrin përgjegjësinë për vete edhe për të tjerë.

Ju jeni pronare e një biznesi në Zyrih të Zvicrës dhe përfaqësuese e zërit të të rinjve në fakultetin e HWZ, në Media e Komunikim. Na flisni pak më tepër me angazhimet dhe përfshirjen tuaj me të rinjtë.

Janë 2 përfshirje: e para është angazhimi im, i cili lidhet me një iniciativë për adoleshentët të moshës 15-16 vjeçare, të cilët mundohen të inkuadrohen në botën profesionale. Aty takohemi rregullisht me të rinjtë për të ushtruar intervista, vetëparaqitjen në mënyrë profesionale ose për të zbuluar se cili mund të jetë profesioni i duhur për një person. Ndihmoj që të organizohen mbledhje të nxënësve çdo vit, ku mund të njoftohen ish-studentët me studentët, ku mund të bëhen bashkë për të hapur një biznes, ose diçka tjetër. Unë, për shembull, pasi kam hapur biznesin, kam pasur shumë sukses sepse kam qenë në mes të plot personave, të cilët ishin në vende punësh të mira gjithkund në Zyrih, të cilët më kanë përkrahur. 'Network, network, network'. E dyta është angazhimi im në bordin e fakultetit, në të cilin ende jam duke studiuar shkencat

ekonomike, ku marr rolin e një "ure" mes profesorëve edhe studentëve. Aty, sidomos në 5 vitet e fundit jam angazhuar duke kontribuar në njoftimin e studentëve mes njëri-tjetrit për të shfrytëzuar sugjerimet në botën profesionale, ose në mënyrë që të mësohen nga njëri-tjetri me dije, eksperiencë etj.

Prej sa kohësh jetoni në Zvicër? A ka qenë e vështirë jetesa aty për ju apo për familjen tuaj?

Po e vërtetë, prindërit kanë ardhur në Zvicër në vitet '90. Fillimi sigurisht nuk ka qenë i lehtë për familjen tonë, por çdo person ia gjen vetë vendin vetes. Babi në atë kohë ka pasur një mentor, i cili ka qenë student, që e ka ndihmuar të mësojë sistemin e arsimit në Zvicër, njësoj si unë sot, që angazhohem. Këtu e shikon se sa e rëndësishme është që t'i ndihmohet të tjerët. Mundesh absolutisht të bësh ndryshimin për një familje. Sot nuk kemi më aq probleme sa kemi pasur para një dekadë. Për shembull: Ne jemi 4 fëmijë, 3 motra e një vëlla. 3 prej nesh kanë biznesin e tyre. Motra me një sallon, vëllai një dyqan 'online' për çanta unike edhe unë me ushqim. Motra e vogël ende është në shkollë. Këtu në Zvicër të presin mirë nëse je një pjesë e vendit, nëse je aktive, nëse punon edhe i rregullon vetes vendin dhe krijon vende pune. Dmth., krijon vlera të shtuara

për bashkësinë.

Nëse bëheni deputete në parlamentin kantonit të Zyrihut, për çfarë do të angazhoheni më shumë?

Angazhimi im do të jetë kryesisht në rrethin Bylach me Partin e FDP-së. Do të angazhohem që të zvogëlohen pengesat burokratike dhe të krijohen kushte optimale për kompani të reja, në mënyrë që kantoni i Zyrihut të mbetet tërheqës për ndërmarrësit dhe inovacionet. Si një ndërmarrëse, arsimit, shkencat dhe inovacioni janë shumë të rëndësishme për mua. Suksesi i Zvicrës bazohet kryesisht në një sistem të shkëlqyeshëm arsimor. Vendet e huaja na lakmojnë për arsimin tonë fleksibël dhe të orientuar drejt së ardhmes. Është e rëndësishme të vlerësojmë dhe të zhvillojmë këtë. Barazia në punë, familje, barazia gjinore janë shqetësimet qendrore për ne. Çdo person duhet të jetë në gjendje të vendosë për veten dhe mënyrën se si ta e formojë jetën e vet, qoftë në punë, në familje apo në kohën e lirë. Kemi nevojë për më shumë modele fleksible në treg të punës dhe kuadro të lartë si gra ashtu edhe burra, si dhe paga të barabarta për performancat të barabarta.

A keni shqiptarë të tjerë të angazhuar në fushatën tuaj elektorale, apo edhe që punojnë në biznesin tuaj?

Po, ka. Unë ndihem shumë krenare sa herë që kuptoj që çdo herë e më shumë shqiptarët po angazhohen në fusha të ndryshme dhe inkuadrohen në shoqëri e kanë ndikim në tema të rëndësishme. Unë nuk jam e vetmja shqiptare femër e angazhuar në politikë. Ka edhe shumë zotëzja të tjera të suksesshme në fusha të ndryshme. Në partinë e FDP-së janë edhe 2 shqiptarë të tjerë, Përparim Avdiçlliu dhe Ylli Doko.

Sa e vështirë ka qenë për Arbelën për të arritur këtu ku është dhe cila ka qenë shtysa juaj dhe ndihma më e madhe për të kaluar vështirësitë?

Prindërit e mi më kanë edukuar në mënyrë që të më nxisin të ecë përpara, të punoj më shumë se të gjithë të tjerët për të arritur një nivel që nuk do të jem e varur nga dikush tjetër. Tema e shkollimit ka qenë tema qendrore në shtëpi. Sot e dëgjon zërin e prindit që thotë "Mëso, mëso, mëso, sepse vetëm atëherë mundesh të arrish diçka". Dituria është fuqi. Besomë kur të them, që gjatë shkollimit, studimit, edhe kohën që kam hapur biznesin, ka pasur 100 herë situata kur jam ndërjerë e pasigurt ose keq, ose e paditur, por çdo herë në momente të tilla kam hipur në tren e kam shkuar në "shtëpi" tek familja... Sepse pa marrë parasysh, kudo që je, mbështetjen më të madhe e ke aty... Vitin e kaluar ka ndodhur që kam shkuar në Kosovë për relaksim që më ka ikur "stresi".

Çfarë mesazhi mund të jepni për të rinjtë shqiptarë në Zvicër si edhe në trojet e tjera?

Që duhet të marrin pjesë në jetë, sepse vetëm nëse bashkëpunojmë jemi të fortë. Plot herë dëgjoj që njerëzit thonë "ah, me politikë nuk mund të arrish diçka, ose politika është e komplikuar". OK, e kuptoj, por politika nuk është gjë tjetër veçse diskursi për të gjetur zgjidhje për bashkëjetesën e sotme dhe për të




ardhmen. Në fusha të ndryshme jam e sigurt që secili ka mendimin e vet. Është shumë e rëndësishme të kontribuojmë në atë vend që jetojmë, që të jetë pjesë e diçkaje më të madhe. Që merr përgjegjësinë për veten, për fqinjin, për rrinin, e cila është e ardhmja jonë. Sa më shumë që kontribuojnë, aq më shumë mundemi të arrijmë. Qoftë në parti politike apo shoqatë e çdo fushë, angazhimi mbetet angazhim. Dhe mos harroni se ju shpërblehet, nga një vend, nga


një shoqëri, nga një parti, si në rastin tim, në FDP. Edhe ajo që është më e rëndësishme: Mundi të bën dallimin për një person, një familje, sidomos në Zvicër, që kemi demokracinë direkte dhe zëri ynë ka vlerë. Është gënjathtë mos marrim pjesë në vendimmarrje. As një shtet tjetër nuk i ka këto të drejta. Ka edhe shtet, ku zëri, sidomos i femrës nuk dëgjohej aspak. Ky rast duhet të na motivojë, sidomos të rinjtë që të inkuadrohen në jetën e tyre.



Prej dy ditësh Kejvina Kthella ka marrë vëmendjen e mediave rozë, pasi "Intv.al" publikoi foto të saj krahas futbollistit Bekim Balaj. Ata dukeshin mjaft të afërt teksa ndodheshin në një nga klubet e natës në Tiranë. Mirëpo pas këtij lajmi, Kejvina ka thënë për "icon-style": "Nuk është e vërtetë që ne jemi të lidhur. Madje, ne nuk kemi qenë aspak në tavolinë bashkë, ka qenë vetëm një moment që ai është afruar të më thotë diçka", - është shprehur modelja. Gjithashtu, ajo shtoi se momentalisht është në një lidhje dashurie, por më dikë që nuk është person publik. Më tej tha se në të njëjtin klub ka qenë edhe mikeshja e saj, Einxhel Shkira. Të jetë e vërtetë, pas atyre fotove aq të afërta me njëri-tjetrin?



Kapet 'mat' me futbollistin në klub, reagon Kejvina Kthella



Jo gjithmonë komentet e ndjekësve ndaj VIP-ave do të jnë pozitive. Për këtë arsye, këngëtarja Aurela Gaçe përballet me komentuesit në rrjetet sociale duke u kthyer atyre përgjigje si për kritikën, ashtu për komplementet që mund t'i drejtojnë. Këtë herë një komentues duket se e ka irrituar këngëtarën, pasi në një nga "Story"-t e saj në "Instagram", ku shfaqet duke performuar ai ka shkruar: "Plakat në sulm". Kaq ka mjaftuar që Gaçe të shpërthejë duke e bërë publike këtë koment si edhe përgjigjen e saj. "Në këtë rast ti e kush mendon si ty, kush fyen, e aq më tepër njerëz që punojnë, ju dërgoj shumë dashuri". Duke treguar gishtin e mesit me emoji, ajo ka shkruar: Kiss my fu*king *ss. Apo e do shqip? Më puth b**** time labe", shkruan këngëtarja. Gaçe njihet për energjinë e saj të pashtershme dhe tipin e drejtpërdrejtë, ku edhe në këtë rast nuk ia ka lënë pa përgjigje të merituar personit që reagoi në të tillë mënyrë.

"Plakat në sulm!", reagon Aurela Gaçe: Më puth b**** time labe

Pothuajse gjithnjë njerëzit nuk janë të kënaqur me pamjen e jashtme të VIP-ave të tyre dhe kështu i kritikojnë në një mënyrë apo në një tjetër. Kjo gjë ndodh edhe me këngëtarën e njohur Fifi, e cila është gjithnjë qendër e kritikave për shkak të peshës së saj. Por kësaj radhe, ajo s'e ka lënë me aq duke publikuar një video në profilin personal në "Instagram", ku është treguar e sinqertë dhe shumë e drejtpërdrejtë. Duke qenë se shpesh është përballur me bulizmin, ajo ka vendosur që të flasë për këtë temë. "Unë jam e bukur. Ju përsërites krejt juve që më keni nisur mesazhe të llojit... 'je si lopë, je shumë e trashë, je vesh shumë 'w-leck' (shpifur), je shumë e shëmtuar, je shumë kështu, je shumë ashtu'. Mbase sot mund të bëjë zhurmë kjo thirrja ime kundër bulizmit... (më besoni që nuk është veç për mua dmth...),... Po nanusha, jam shumë e bukur, ndihem e bukur dhe ndihem e veçantë... Natën", - shkruan këngëtarja. Shkurtër, pastër e qartë, apo jo?



Këngëtarja shpërthen ndaj bulizmit: Mbase sot mund të bëjë zhurmë kjo thirrja ime!



Pas fotos së postuar nga faqja "Vipat e Bilokut", është acaruar keq këngëtarja Enca Haxhia. Ajo është fotografuar në tualetin e një lokali, duke shfaqur situatën ku këngëtarja ka qenë pa mendje dhe ka bërë foton. Kanë qenë të shumta edhe reagimet e komentuesve, pasi duket qartë ndryshimi i këngëtares 'live' dhe në fotot që ajo publikon në rrjetet sociale. E acaruar nga veprimi, Enca ka reaguar nëpërmjet një postimi në rrjetin social "Instagram". E dini çfarë është më shumë patetike? Njerëzit që krahasojnë foton time sapo dal nga banja me fotot në "Instagram". Leksion për ju deshtakët: Unë jam aq e çmuar dhe e rëndësishme, sa që ju fotografoni mutin tim. Unë jam zoti juaj. Dhe sa për krahasimet... edhe në ditë e mia më të këqija, ndihem si krijesa më e bukur në botë, sepse ashtu jam. Dhe kështu duhet të ndiheni të gjithë (përveç ziliqarëve, ju keni zot mutin tim)".

"Ju keni zot m**in tim!", Enca reagon keq pas fotos që i publikojnë nga WC-ja

BULEVARDI

POLITIK

Në merrni seriozisht!

"Komodim i ri", Bregu shfaqet në shtëpinë moderne në Sarajevë

Ajo shihet e ulur në divan, ku ka një lap-top në prehër dhe në sy bie arredimi i shtëpisë mjaft modern. Majlinda Bregu, ish-ministrja e Integritimit në qeverinë "Berisha" është zhvendosur përfundimisht në Bosnjë Hercegovinë. Ajo ka publikuar një foto ku shihet se është rehatuar në shtëpinë e saj të re në Sarajevë. Majlinda ndodhet e ulur në divanin e dhomës së ndenjes, ku në sy bie arredimi mjaft modern. "Komodim i ri", - shkruan Bregu krahas fotos.



Julian Deda ironizon Ramën, anëtari i PD publikon foto nga dushi

Aktori i njohur i humorit, njëkohësisht edhe anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së, Julian Deda ka ironizuar së fundmi kryeministrin Edi Rama. Jul Deda publikoi një foto nga dushi, ku shihet me fytyrën e bërë me shkumë, njësoj si ajo e Ramës në videon e publikuar nga Ermal Mamaqi. "Ai momenti kur laheshe si piktor...!", shkruan aktori krahas fotos.

Ironia e zv.ministrit të Ramës: Protestë kundër ndryshimit të motit

Ndërsa studentët kanë hyrë në ciklin e dytë të protestave, zv.ministri i qeverisë "Rama" ka një tjetër ide për protestat. Zv.ministri i Mbrojtjes, Petro Koçi fton miqtë e tij të 'protestojnë' kundër ndryshimeve të motit, që ka sjellë rënie të ndjeshme të temperaturave. "Të protestojmë kundër ndryshimeve klimaterike duke mbjellë pemë", shkruan Koçi duke dashur kështu "t'i marrë ekskluzivitetin" Erion Veliajt.



Putin qëllon me top nga fortesa e Shën Peterburgut

Presidenti rus, Vladimir Putin vizitoi fortesën e Peterit dhe Paolos në Shën Peterburg me rastin e Krishtlindjeve dhe siç e kërkon tradita, bëri një goditje me topin e fuqishëm, një prej dy modeleve D-30, duke shënuar mesditën. Tradita e goditjes së mesditës është në fuqi që prej vitit 1865. Pas performancës së Putinit, një prej spektatorëve thërriti "në shenjël!". Ndërsa Putin duke qëndruar në lojë, u përgjigj me një batutë: "Është e vështirë të gabosh objektivin me këtë...".



KUJTIME

KOLEC TOPALLI:

Petro Marko në shtëpinë time dhe jeta në kampin e Tepelenës

Fatmira Nikolli

Ishte 23 maji i 2018...

Ai e priste prej meje parathënien e librit të fundit. Shkëmbyem mesazhe të një falënderimi për punën që kisha ndër duer dhe i shpjegova se: "...më duhesh edhe pak kohë me ia dhanë dorën e fundit..." Qe një trishtim i madh, kur pikërisht të nesërmen mora lajmin e humbjes së tij. Edhe pse e dija se ishte mjaft i sëmunë, dhe pse shëndeti i tij kohët e fundit po i shkonte drejt shuëmjes, s'doja kurrsesi me e besue kët gjë. Si zot i fatit të vet, ai i kishte mbyllë n'paqe logaritë me jetën, edhe pse ajo ishte sjellë ashpër me të... Herën e fundit ndejtëm gjatë, e folëm mjaft për Fjalorin Etimologjik të Shqipërisë. Ndër tjera, më tha se "Botimi i kësaj vepre, asht kunorzim i krejt punës sime gjysmëshkullore... Jam i kënaqun! Munda me i realizue krejt projektet që i kisha vu vedit në jetë... Kjo ishte e fundit... Po shkoj përtej pa asnjë peng...". Rrëfimi i Jozef Radit për Kolec Topallin është i ndër. Në parathënien e librit me kujtime "Një jetë me brenge" botuar pas vdekjes së gjuhëtarit nga Instituti për Studimin e Krimeve dhe Pashojave të Komunizmit, Radit ndalet gjatë te mik i tij. "Tragjedia e familjes Topalli asht një prej ma të dhimbshmeve. Mbas 'çlirimit' ata nuk mbërritën kurrë me u ba të tanë bashkë, as ndër gëzimet e pakta, as ndër idhnimet e shumta, që jeta (falë njerzve të pushtetit të ri) s'prahti duke ua dhurue më shumicë."

Ishin vitet '60, kur familja Topalli, sapo e kishte lanë kampin e internimit në Savër, kur familja ime, sapo ishte dërgue me qëndrue për 30 vite të tjera aty. Veçse jehona e vlerave e qëndrimeve t'asaj familje që kishin jetue në krejt kampet e deriat'hershe ishte e gjallë, e prekshme, lëvduese! Çka kishte pësue ajo familje, ishte në sinkron me shumë prej familjeve ma të randsishme, që në indeksin komunist të mbas '44, ishin damkosë armiq të popullit; reaksionarë dhe ata që i pinin gjakun popullit! - thotë Radit në hyrjen e librit. Ai na përgatit se faqe pas faqeje të këtij libri biografik, autori është përpjekur të jetë sa ma lakonik e sa më i rezervuar. "Familja, që për Topallët ishte e shenjtë, qe shpërnda e kishte humbë e gjitha pikat e takimit mes vedi. Nji katastrofë humane që askush s'mundet ta besojë e as ta kuptojë pse e gjithë kjo urrejthe ndaj nji familje të papërzime, e nga ma të pasunit tregtarë të Shkodrës. Kjo



pyetje mbetet e pa përgjigje, sepse çdo përgjigje s'do të mundet kurrsesi me u ba e plotë dhe e kuptueshme as prej vetë barbarëve që morën shtetin shqiptar, me e shndërrue në vendin ma tragjikomik të Europës...", vëren Radit.

Ai shton se ndërsa ngjit të përpjetën e ashpër të librit autobiografik "Një jetë me brenge" të Kolec Topallit, shpesh duhet m'u ndalë, me marrë frymë thellë, e me thanë: "Asht e pamundun!", mandej të duhet m'e ndjekë kët

Sizif modern tek ngjitet i paepun në t'përpjetë të fatit, e me ba nji refleksion ndërgjegjeje; të duhet m'u marrë me absurdin e këtij pushteti që kishte në themele t'veta shkatërrimin e vlerave të njeriut, t'intelektualit e të familjes; duhet me besue se ajo kohë s'mundesh me qenë pafundsisht e gjatë... dhe t'i ndjek nji fëmijë që shëtit kampeve të internimit, dhe s'e kupton pse ai duhet t'ishite në Porto Palermo, në Turan, në Tepelenë; pse duhet familja e tij të kthehet me vujetë në Savër... ndërkohë që njeriu lufton me qenë bashkë e me ndërtue nji jetë të re... Po ç'jetë e re do t'ishite ajo ecje në tëh të humerës, ku herët a vonë njeriu i pafajimë do ta gjente vedin nën kthe-trat e kriminale të regjimit.

Për Radin, nga bregu i së Keqes dhe nëntoka e Hadit, me filozofinë e pikës që grryen shkambin. Kolec Topalli mbritti majën e asaj lavdie të përkorë e të pazhurmët. Mbasi ndërtoi kët korpus veprash akademike dhe nji personalitet të njof-tun shkencor si në fushën e gjuhës e albanologjisë shqipe, ai mbajti referate në universitetet ma të njoftuna të Ballkanit, Europës e ma gjanë. Kjo, falë e natyrës së tij të paqme e të paepur, falë vullnetit të tij të hekurt e kambëngulës, falë rregullsisë dhe skrupolozitetit në trajtimet shkencore, falë përkushtimit me cue përpara punën akademike, falë nji mirësie të pazhurmët, ai mbetet ndër personalitetet ma të spikatuna të periudhës post-diktaturë. Drejtori i ISKK-së, Agron Tufa, si një prej atyre që e kanë nxitur Topallin të hidhte në letër kujtimet, ka thanë se "profesor Koleci nguronte t'i shkruante", por tashmë që kemi humbur Topallin gjejmë jetën e një njeriu të thjeshtë në librin e tij "Një jetë me brenge".

PARAFJALË E TOPALLIT

Gjatë gjithë jetës sime nuk kam menduar se ndonjë ditë do të ulla të shkruaj kujtimet e një jete të kaluar plot brenge; madje, nuk kam mbajtur as ditar. Prandaj edhe këto kujtime janë shkruar në moshën 70vjeçare. Arsyja që më shtyu të hedh në letër këto kujtime është dëshira që brezi i rritur në demokraci të njohë sa e vësh-tirë ka qenë jeta e intelektualëve dhe e gjithë popullit shqiptar në regjimin totalitar komunist. Prandaj, në përputhje me këtë qëllim, në këto kujtime jam përqendruar vetëm në disa aspekte të jetës sime, që me fakte konkrete shtjellojnë ashpërsinë e luftës së klasave, e cila përbën absurditetin më të madh të atij regjimi, njëkohësisht edhe faqen më të dhimbshme të tij. Për këtë arsye kam lënë jashtë çdo gjë që lidhet me jetën personale e famil-



jare, duke u përqendruar në marrëdhëniet e mia me pushtetin komunist dhe me botën shkencore, që ka qenë tej mase e politizuar. Sigurisht, të vërtetat e këtyre kujtimeve nuk janë asgjë para vrasjeve, burgosjeve, torturave çnjerëzore dhe sa e sa mizorive të tjera, që ka kryer diktatura komuniste për 50 vjet me radhë. Megjithëkëtë, ato plotësojnë kuadrin e përgjithshëm të mungesës së lirive, të përndjekjeve dhe nëpërkëmbjes së intelektualëve dhe të gjithë popullit.

NJOHJA ME PETRO MARKON

Mbaj mend gjithashtu se në periudhën e fundit të luftës, me porosi të Këshillit të qytetit, ka jetuar në shtëpinë tonë për disa muaj shkrimtari Petro Marko, aso kohe i ngarkuar i redaksisë "Bashkimi" për zonat e Veriut të Shqipërisë. Ai qëndroi në familjen tonë si një pjesëtar i shtëpisë. Megjithëse kishte dhomën e tij ku flinte e punonte, ulej gjithnjë në tryezë për të ngrënë me ne, ku bëheshim gjithsej 8 vetë. Ishte shumë i afërt me ne të vegjlit, me mua dhe me vël-lain tim, që kishim afërsisht një moshë. Shpesh na recitonte ndonjë vjershë në frëngjisht, që e kujtoj edhe sot. Në kujtimet e tij të asaj periudhe, të botuara në librin "Intervistë me vetveten Retë dhe gurët", ai shkruan: "Mua më mbajtën në Shkodër për të botuar Buletinin e Korparmatës së Tretë. Flija në shtëpinë e Nush Topallit, ku merrja lajmet me radio dhe përgatitja lëndën të "Jeta e re"... Familja e Nush Topallit më ka mbajtur si bir të saj, shumë familje bujare, patriotë dhe fisnike. Mirëpo në Shkodër, siç duket me ndikimin e malazezëve, nisi ndjekja kundër katolikëve. Kishin ardhur shumë podgoricanë dhe ata ishin thuajse shumica. Nisi rrëmbimi i mallrave,



zbrazja e dyqaneve nga jugosllavët. Shkodranët ishin tmerruar dhe prisnin se ç'do të bënte qeveria shqiptare: a do t'ua ndalonte sllavëve rrëmbimin e mallrave, zbrazenj e dyqaneve? ... Edhe Nush Topalli, një njeri me mend dhe në ndershëm, një mbremje, duke ngrënë bukë në shtëpinë e tij, më pyeti me druajtje:

Më falni, zoti Petro. Unë e di që ju jeni një patriot i ndershëm dhe dua t'ju bëj një pyetje. A më lejoni? Unë ha bukën e një vëllai shqiptar, iu përgjigja, si të mos kem besim dhe respekt për të? Ç'doni të më thonit?

Ai më pyeti: Pse, zoti Petro, po na zhveshin sllavët? Të paktën të marrin një pjesë e një pjesë ta mbajmë dhe ne, se ku t'i gjejmë tërë këto mallra të çdo kategorie: që nga lënda e ndërtimeve, te manufaktura, te makineritë e te pijet... Më vjen keq, vërtet miku është mik, po duhet t'i japim ne atë që kërkon, dhe jo t'i hapë ai vetë depot, magazinat e dyqanet... dhe t'i zbrazë pa na thënë as faleminderës! Unë e kuptoj këtë zoti Petro. I shoh të gjitha dhe hesht, se, po hapa gojën, burgu më pret...

Nuk e kuptoja këtë veprim zhvatës pa skrupull nga ana e druzheve... Të gjithë katolikët shiheshin me sy të keq, madje nisi dhe arrestimi i tyre".

SI NISI GJEMA

Më kujtohet ende dita kur u pushtuata daja. Ishte data 3 shkurt e vitit 1948. Që herët, pa u gdhirë ishin dëgjuar të shtëna armësh në Shkodër.

Viktimit e këtij terrori ishte edhe vëllai im. Duhej një edhe prej familjes Topalli. Dhe meqenëse babai ishte në burg për tatime dhe vëllai i madh "vullnetar" në hekurudhë, i erdhi radha vëllait tjetër, Gjenarinit, në atë kohë djalosh 20-

vjeçar, që u burgos dhe pas një viti e më shumë qëndrimi pa gjyq e nën tortura për të pranuar akuzat e falsifikuara, u dënua me 2 vjet burg me akuzën qesharake "ke dalë e ke hapë derën e oborrit për ata që vinin në mbledhje dhe ke ndejë roje gjatë zhvillimit të mbledhjes", në një kohë që në shtëpinë e Serreqeve nuk ishte bërë asnjëherë ndonjë mbledhje e tillë, por ishte vetëm një sajim i Sigurimit të Shtetit për të dënuar njerëz të pafajshëm.

Pjesën e mbetur të dënimit vëllai e kaloi në kampin shfarosës të Bedenit të Kavajës, ku të burgosurit sfiliteshin në punë të rëndë dhe vuanin për bukë e për ujë, aq sa, kur u lirua, mezi njihej, aq shumë ishte dobësuar.

NË INTERNIM

Vëllai i madh, Hila, i mobilizuar për të punuar si arsimtar në fshatrat e thellë të Veriut, ishte emëruar në Palç të Tropojës, prej nga u arratis në prill të vitit 1949. Tri ditë pas kësaj ngjarjeje e tërë familja u internua. Ky qe një shkatërrim i vërtetë familjar. U ndamë në 4 pjesë: babai në burgun e Shkodrës, vëllai i madh jashtë shteti pa e ditur se ku, vëllai i dytë, Gjenarini, ushtar në Përmët, kurse nëna Marie, motra Suzana, vëllai tjetër Ferdinandi dhe unë morëm rrugën e internimit.

Atë vit, kur u internuam, unë isha 11 vjeç dhe ndiqja klasën e pestë të shkollës 7-vjeçare. Qenë ditët e para të prillit 1949 kur dy punonjës të Sigurimit erdhën në mëngjes herët dhe na njoftuan të bëheshim gati se do të na internonin. Nuk kishim fare dijeni për çka kishte ndodhur, sepse para pak ditësh kishim folur në telefon me vëllain. Gjithçka u bë pa asnjë njoftim dhe pa asnjë gjyq a vendim, madje, pa as edhe një shkresë. Në atë kohë asnjëri s'kërkonte gjëra të tilla. Na lanë vetëm një orë kohë

për të përgatitur rrobat e për t'u nisur. Kështu, atë ditë, në vend që të shkoja në shkollë, bashkë me familjen na hipën në një makinë dhe na mbyllën në Degën e Punëve të Brendshme.

Na ngarkuan në karrocerinë e një kamioni të hapur. Rrugës heshje e plotë. Asnjë nuk e dinte ku do të shkonim. Një polic me automatik që na shoqëronte, rrinte në krye të karrocërisë në këmbë, ngjitur me kabinën e shoferit dhe nuk fliste asnjë fjalë. Sigurisht që për të ne ishim armiq të rrezikshëm dhe ai ishte ngarkuar që të na ruante se mos largohej ndonjë. Kalam Vorën, lamë Durrësin dhe vijuan udhëtimin edhe për disa orë. Më në fund, kamioni u fut në një qytet dhe u ndal para një porte. Aty do të zbrisnim. Kishim arritur në destinacion, në qytetin e Beratit. Ky qe stacioni i parë i internimit.

Ndërtesa ku u vendosëm ishte një han i braktisur në lagjen "Çelëpije". Në një dhomë rrinim disa familje bashkë...

Por në Berat nuk qëndruam gjatë, më pak se një muaj, pasi aty ishte caktuar vetëm qendra e grumbullimit të familjeve që vinin nga të katër anët e Shqipërisë, shumica e të cilave ishte nga Veriu.

Pas tri javësh çdo gjë u bë gati për njëse. Të ngarkuar në karrocëritë e makinave të hapura, përsëri me një polic që na shoqëronte, u nisëm, gjithsej 7 makina në kolonë, pa e ditur ku po shkonim. Si gjithnjë destinacioni ishte sekret. E njëjta skenë si ajo kur u nisëm nga Shkodra. Udhëtimi u bë përgjatë gjithë natës. Rrugës, që zgjati më shumë se 8 orë, njëra makinë në rrëzua dhe u rrokullis poshtë në një luginë të thellë. Pati 2 të vdekur e shumë të plagosur. Të gjitha këto i morëm vesh kur arritëm në mëngjesin e ditës së nesërme në disa kazerma ushtarake, ku ishte vendqëndrimi ynë. Kishim arritur në një repart ushtarak, në fshatin "Turani të Tepelenës. U sistemuan në kazermën numër 3, që për fatin tonë ishte e mbyllur, ndërsa shumë të tjera ishin të hapura. Familjet brenda kazermës vendoseshin në radhë njëra pas tjetrës dhe formonin 3 rreshta. Mund të numërohehim më shumë se 4050 familje në një kazermë, ku të gjithë flinin për një, në cimento. Ne shtruan dy rrogoza, por meqenëse nuk na takonte kaq vend, gjysmën e njëtrës rrogozë e zuri një e internuar tjetër, një grua e vetme nga Dibra, së cilës i ishte arratisur burri. Në një metër e gjysmë vend mund të flinin gjithsej 3 persona, unë nëna dhe vëllai, kurse motra, që ishte në moshë pune, punonte në një fshat tjetër rreth dy orë larg dhe vinte vetëm një herë në javë për të na parë. Aty, nga maja e një mali ngarkonin dru në kurriz dhe i sillnin poshtë në fushë. Ishte një punë shumë e rëndë. Shpeshherë gjatë rrugës rrezoheshin nga pesha e ngarkesës. Kur nuk plotësonin normën, rrinin deri natën vonë për ta plotësuar.

Jeta në kamp qe shumë e vështirë. Çdo natë bëhej apeli për të kontrolluar se mos largohej ndonjë. Të vetmet çaste gëzimi ishin kur shpërndaheshin postat, sigurisht pasi ishte hapur e kontrolluar nga drejtorja e kampit. Atëherë mund të degëjoje emrat e shumë familjeve që jetonin prej vitesh në kampe: Gjomarkajt, Kupi, Miraka, Dineja,

//

Mbaj mend gjithashtu se në periudhën e fundit të luftës, me porosi të Këshillit të qytetit, ka jetuar në shtëpinë tonë për disa muaj shkrimtari Petro Marko, aso kohe i ngarkuar i redaksisë "Bashkimi" për zonat e Veriut të Shqipërisë. Ai qëndroi në familjen tonë si një pjesëtar i shtëpisë.

Dosti, Mulleti, Repishti, Merlika, Dema, Bushati, Kazazi, Ndreu, Bajraktari, Kaloshi, Cenelezi, Previzi, Radi e shumë të tjerë. Të dukej sikur po shfletoheshin faqet e një libri historie.

Në fillim çdonjëra familje mundohet ta përballonte vetë jetesën me ato që mund t'i dërgonin njerëzit e farefisit; por kur filluan vdekjet në masë nga uria, drejtoria e kampit u detyrua të vërë kazanin e ushqimeve: një supë e një racion bukë, edhe kjo një herë në ditë. Ujin e pijshëm e merrnin në mal një gjysmë ore më këmbë, në një cisternë prej hekuri, që bashkë me ujën nxirrte edhe krimba të vegjël me ngjyrë të kuqe. Banja nuk kishte. Gjithçka në natyrë, nën qiellin e hapët. Edhe për të larë trupin, me një kusi me ujë që e ngrohnim me degë shkurresh. I ngjiteshim malit për të gjetur ndonjë skutë të fshehtë ndërmjet kaçubash. Më vonë, vetë të internuarit në afërsi të kampit hapën një gropë, që e rrethuan me degë dëllinjash. Banorët e fshatit, që ndodheshin më majë të një kodre, mbanin qëndrim shumë të ftohtë ndaj nesh. Nuk donin kurrsesi të kishin kontakte me ne. Jo vetëm nuk na flinin fare, por as nuk pranonin të na shisnin ndonjë gjë me para në dorë, kurse në dyqanin e vetëm të kooperativës së shitblerjes në Tepelenë, ku mund të shkonim vetëm me leje të komandës, kishte vetëm gorrica.

Pas 6 muajsh erdhi urdhri i transferimit. Lëvizëm përsëri, këtë radhë më afër nga Turani në Bëncë, më pranë Tepelenës. Përsëri në kazermë ushtarake, me të vetmin ndryshim se, në vend të cimentos, kishim shtretër marinarin prej dërrase në tërë gjatësinë e kazermës. Kështu numri i familjeve që strehoheshin brenda kazermës, ishte dyfishuar dhe kontrolli i njerëzve bëhej më lehtë, mbasi edhe rregullat e apelit u bënë më të rrepta, duke qenë se kampi ndodhej më afër qytetit të Tepelenës. Kishte raste kur atë e bënin në orët e vona të mbremjes, duke detyruar të mëdhenj e të vegjël të ngriheshin nga gjumi e të zbrisnin nga krevetat.

Ja si i përshkruan vuajtjet e pafund në kampin e Bëncës një ish e internuar, Elena Merlika, e cila, pasi u end kampeve të internimit për 45 vjet me radhë, mundi të shihte dritën e lirisë e të riatdhesohej në vendlindjen e saj vetëm pas vitit '91, atëherë kur u shemb njëherë e përgjithmonë diktatura komuniste, që mbante në këmbë kampe të tilla.

PORTO PALERMO

Në Bëncë nuk qëndruam gjatë, vetëm pak muaj, se përsëri erdhi urdhri i transferimit për në një vend tjetër.

U ngjitem një kodre dhe na strehuan në një kështjellë me mure rreth dy metra të trashë, pa dyer e pa dritare. Jashtë kështjellës drurë e shkurre mbulonin kodrën, majë së cilës naltohej e vetmja ndërtesë, kështjella ku u strehuam. Më tej deti i pafund. Ishim në Porto-Palermo, vend ideal internimi e izolimi të plotë, ku vetëm një rrip toke na lidhte me pjesën tjetër të vendit. Por mua nuk më takoi të rrija gjatë aty, se, posa arrita në Porto-Palermo, u sëmura rëndë dhe më çuan në spitalin e Himarës. Për 3 javë isha në mes të jetës e të vdekjes. Por në këtë luftë kjo e fundit u mund e një ditë prej ditësh e lashë spitalin dhe i ndihmuar nga motra dhe një e internuar tjetër, shoqe e saj, i kapur përkrahësh në të dyja anët, u ngjita kodrës për të shkuar në kështjellën që e kishte ndërtuar Ali Pashë Tepelena.

Jeta në kështjellë nuk ndryshonte nga ajo e kazermave. Në dhomat e mëdha brenda mureve të trasha banonin disa familje. Gjithçka ishte gur e beton. Nga frëngjtit që nuk kishin dritare dhe nga hyrja që s'kishte derë, fishkëllente era e ftohtë e dimrit, që vinte nga deti dhe rrihte pa pushim majën e kodrës ku ishte kështjella. Në mes të dhomës pa oxhak, një zjarr që nxirrte tym dhe të verbonte sytë, rrinte i ndezur gjatë gjithë natës.

Në një vizitë të Porto-Palermo, një surprizë e vërtetë e priste vajzën time, Joanën. Kur u ngjit sipër, në tarracën e sheshit të kështjellës, të internuarit fatzjiv kishin lënë si kujtim emrat e tyre, ashtu si të burgosurit në burgun e Burrelit, Spaçit e Qafë-Barit. E ndërmjet emrave të shumtë, kishte gjetur emrin e njerit prej pjesëtarëve të familjes sonë: Ferdinand Topalli (vëllai) dhe një datë: 10-XII-1949. Ishte mallëngjyer shumë. As rrebeshet e stuhitë e dimrit, as vapa përvëluese e verës nuk e kishin shlyer këtë simbol të pafajësisë së një djaloshi 12-vjeçar dhe të hakmarrjes së verbët të një regjimi totalitar, që dënonte pa dallim burra, gra, fëmijë e pleq të pafajshëm.

Pas Vitit të Ri për mua dhe vëllain erdhi falja. Nuk mund të mbahehim më sidomos fëmijët, që vdiqnin nga uria e sëmundjet.

Bashkë me disa të mitur të tjerë të kampit u larguam nga Porto-Palermoja dhe për tri ditë qëndruam në Degën e Punëve të Brendshme të Himarës, derisa u gjet një makinë që na çoi në Tiranë. Një mik i familjes, që na pa në oborrin e Policisë së Rajonit, na mori në shtëpinë e tij dhe na nisi për Shkodër, ku shkuam të banojmë te gjyshja.

U ndamë nga familja, se nëna, motra dhe babai që ishte liruar prej burgut, vijuan kalvarin e mundimeve edhe për 6 vjet të tjera, duke e kaluar më të shumtën në Savër të Lushnjës...

Opinion *i* Ditës

Kush e do më shumë Shqipërinë se Partinë, t'u bashkohet studentëve

Nga Bislim Ahmetaj

(vijon nga faqja 1)

... jo vetëm fizikisht, por edhe moralisht dhe psikologjikisht. E kam shprehur edhe në fjalime që kam mbajtur para kryeministrit, edhe në rrjetet sociale edhe në rrethin e miqve të mi pedagog, artistë dhe njerëz të zakonshëm. I kam mbështetur si prind, si pedagog në njërin prej universiteteve publike të vendit, si njëri i angazhuar dhe si njëri i revoltuar me realitetin dëshpërues që po përjetojmë si qytetarë, si shtetas, si intelektual. I kam mbështetur si prind i dy djemve studentë që me mish e me shpirt jam munduar t'i mbaj jo vetëm të lidhur me Shqipërinë, t'i mbaj jo vetëm të lidhur me Atdeun, por t'i mbaj akoma në Shqipëri.

Studentëve u dhimbset Shqipëria, e cila si pasojë e politikave korruptive dhe antishqiptare të ndjekura nga qeverisja e sotme, po shndërrohet me shpejtësinë e dritës në një azil gigand pleqsh. Pedagogët e universiteteve publike duhet t'i mbështesin studentët e tyre, pasi në këto institucione edukative e formuese kemi gjetur vullnetin, dëshirën, angazhimin, përpjekjen, këmbënguljen, sakrificën e studentëve dhe stafit akademik për të bërë maksimumin e angazhimit për të dhënë më të mirën e mundshme por, edhe pamundësinë për t'ia arritur kësaj.

Pikësëpari, për shkak të mungesës së vizionit politik të qeverive që kanë shoqëruar tranzicionin e gjatë të vendit për vlerësimin e arsimit si njëri prej kyçeve të zhvillimit të qëndrueshëm të një shoqërie moderne.

Së dyti, të një ligji abstrakt, krejtësisht të pazbatueshëm dhe arbitrarisht të arsimit të lartë, i pasintonuar me nivelet e tjera të arsimit. E



gjithë reforma arsimore ka qenë një handicap si pothuaj gjithçka tjetër në këtë vend, por duke qenë se arsimit është "hapi i parë" i zhvillimit dhe qëndrueshmërisë në zhvillim", reformat e tjera e kanë humbur rëndësinë që në vizion! Gjendja e frikshme e Shqipërisë

është prova e dështimit. Kam qenë skeptik për shumicën e reformave që ka marrë qeveria e "rilindjes së komunizmit" edhe për një arsye tjetër: frymëzuesi, drejtuesi dhe analizuesi i rezultateve është një njëri i çmendur dhe pasionant jo ndaj shtetit, por ndaj pushtetit.

Kësisoj ne si pedagog, studentë dhe prindër, pavarësisht energjive dhe pasionit, do ta kemi të vështirë të arrijmë ndonjë rezultat të kënaqshëm, sepse "fanari ynë ndriçues", ai që po udhëheq me sukses dështimin e përpjekjeve tona, është i gatshëm të blejë edhe

kryetarin e opozitës dhe jo dy apo tre ekspertë që merren me "prodhimin" e një ligji. Ne duhet t'i mbështesim protestat e studentëve me besim dhe shpresëplotë si njerëz të angazhuar, si njerëz të lirë. Personalisht i kam mbështetur edhe nga pozicioni i drejtuesit të një organizatë idealistësh, siç është Grupimi "Dhjetor '90". I kam mbështetur dhe jam shpresëplotë në suksesin e protestës së studentëve si një njëri i revoltuar, pasi në këtë vend tranzicioni 28-vjeçar ka goditur dhe i ka revoltuar të gjitha grupet e interesit, të cilat është e panevojshme t'i përmend, pasi vetë revolta e studentëve të universiteteve publike që janë të paktën 140 mijë vota është sinteza më e plotë e tyre! Ata janë përfaqësuesit e 120 mijë familjeve që kanë së paku nga katër anëtarë që do të thotë as më shumë as më pak se gjysma e popullsisë që jeton në Shqipëri. Kjo protestë dëshmon edhe krizën e thellë, në të cilën është zhytur klasa politike që prodhoi tranzicioni 28-vjeçar.

Liria dhe demokracia që buruan nga Dhjetori i 90-ës janë shëruar plotësisht. Jo se energjitë e çliuara ishin të kufizuara, por se ne, në atë kohë jo për fajin tonë, për dhjetëra arsye, i lëshuam filizat e lirisë në duar të pasigurta. Kjo është edhe një prej arsyeve, se pse bashkëpunëtorët e mi dhe unë, i kemi mbështetur me çdo mundësi Protestat e studentëve të Dhjetorit 2019! Studentët dhe protesta e tyre janë shans i vetëm për të bërë vetëgungë dhe politikës shqiptare, ata janë të vetmit që mund ta ngjallin shpresën, ne duhet dhe do t'i mbështesim, t'iu ofrojmë përvojën dhe ekspertizën tonë, që, të paktën, të mos përsërisin gabimet tona!

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE
MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE
DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



Opinioni *i* Ditës

Pse SHBA-të i duhen sistemit aktual botëror

Nga Rigels Lenja

(vijon nga faqja 1)

... më shumë se sa një fuqi neo-imperialiste, duke e mbështetur këtë ide, tek zhvillimet e luftës së Vietnamit (1955-1973), Afganistanit (2001-) dhe Irakut (2003-). Tri frontet ku SHBA-të, duket se kanë fituar për t'i përmblyllur me fitore: Në të parën luftën ndaj "djallit" të kuq dhe në dy të tjerat ndaj terrorizmit.

A është sot Amerika një fuqi që po priret drejt vetizolimit? Diplomacia amerikane e ka treguar këtë në të paktën dy raste. Vendosja e tarifave dhe barrierave ekonomike ndaj aleatëve të saj si: BE, Japoni, Kanada, Meksikë apo fuqive në rritje, por rivale, si Kina. Një dëshmi se SHBA-të po priren të izolohen në planin e shkëmbimeve ekonomiko-financiare, që automatikisht sjell izolimin politik.

Së dyti, tërheqja e SHBA-së nga Siria, jo vetëm i hapi rrugë për fuqizimin e mëtijshëm të Iranit, Rusisë dhe Turqisë. Por tregoi një lodhje të publikut amerikan nga luftërat e gjata, që deri diku nuk e rrezikojnë në mënyrë direkt tokën amerikane.

Vakumi që mund të lërë tërheqja amerikane nga arena botërore, sigurisht do të kërkohet të mbushet nga fuqi të tjera.

Po kush janë fuqitë që rivalizojnë për të marrë rolin e liderit botëror? Duket se në "pole-position" janë Kina dhe Rusia. Dy fuqi me një civilizim të hershëm dhe me të shkuar imperialiste. Problemi më i madh i këtyre dy vendeve është se nuk janë as vende të lira dhe as demokraci të mirëfillta.

SHBA-së, megjithëse mund t'i veshim shumë kritika, ka disa elemente që e bëjnë atë ndryshe nga çdo fuqi e mëparshme me rol botëror. Së pari, SHBA-të janë një demokraci e konsoliduar. Është nga ato vende, ku gjykatat kanë fuqi të kthejnë mbrapsht apo të rrezojnë, vendime të Presidentit apo Kongresit. Gjë e cila është praktikisht e pamundur të ndodhë në rastet e Kinës apo Rusisë. Së dyti, SHBA-të kanë eksportuar në botë jo vetëm armë, filma dhe produkte ushqimore por, edhe një model sho-



qëror dhe kulturor. Aq sa dhe Amerika u quajti "land of dreams".

Sigurisht, edhe vendet e BE janë demokraci të konsoliduara dhe me të shkuar aktive në arenën ndërkombëtare. Mes tyre shquhem Franca, Britania e Madhe dhe Gjermania. Por realisht e kanë të vështirë, të përballen direkt me fuqi si Kina apo Rusia. Kjo u dëshmuar në rastin e krizës së Ukrainës në vitin 2014, kur Kancelaria Gjermane u detyrua të thërrasë në ndihmë amerikanët, për të përballuar Rusinë, në tentivën e kësaj të fundit për të mos rrëzuar presidentin Ukrainas pro-rusë Janukovic. E njëjta histori u përsërit me rastin e liderit libian Gedafi. Franca dhe Britania, nisën të parat "kryqëzatën" për rrëzimin e tij, por shpejt u

detyruan të kërkonin edhe ato ndërhyrjen e SHBA-së. Në 60 vitet e fundit, Franca dhe Britania, kanë ndjekur me apo pa dëshirë, çdo vendim që ka marr nga Washingtoni, duke patur pak ndikim në çështjet me rëndësi globale.

Si qëndron raporti historik i SHBA-së me izolimin?

Amerika është treguar së paku dy herë shpëtimtare për Europën dhe botën, herën e parë kur vendosi të hynte në Luftën e Parë Botërore, në vitin 1917 duke sjellë fundin e luftës dhe paqen.

Dhe së dyti, në mposhtjen e Nazizmit. Shumë gjeostrategj dhe studiues, e kanë provuar se pa ndërhyrjen e SHBA-së, Lufta e Dytë Botërore, në rastin më të keq do ishte fituar nga nazistët ose në

rastin më të mirë, nazistët do ta humbitnin luftën, por ajo do të zgjatej më shumë në kohë, me dëme të pariparueshme edhe për ditët e sotme. Në të dyja luftërat duhet theksuar se angazhimi amerikan, u ndërmor me thirrje të vazhdueshme nga fuqitë europiane.

Megjithëse duket e vështirë, një largim kaq i shpejt i amerikanëve nga kontrolli botëror, pas kaq shumë vitesh investime. Po ashtu është e pamundur që vakumi i lënë nga një largim amerikan, të mbushet nga një fuqi e vetme. Në rastin më të mirë, kjo do të çonte në një copëzim të kontrollit botëror që thjesht do na kthente në një situatë të ngjashme me atë të para-Luftës së Parë Botërore.

***Studiues**

HOROSKOPI

DASHI

Edhe pse mund të keni një milion gjëra për të bërë, do të gjeni një mënyrë për t'i lënë ato në pritje kur miqtë tuaj të kenë nevojë për ju sot. Ndhima për njerëzit e tjerë do t'ju ndihmojë, duke i parë gjërat nga perspektiva e dikujt që është në hall.

DEMI

Gjërat po përmirësohen në jetën tuaj profesionale ose akademike, pjesërisht për shkak se po ndërmerrni një iniciativë më të madhe, që ju çon në drejtim të reja. Përpiquni të relaksoni mendjen për t'u mbushur me energji.

BINJAKET

Sot, kërkoni një ritëm më të ngadalët për jetën, kjo do t'ju mundësojë që të keni shumë më tepër komunikime të drejtpërdrejta. Email-et janë efikase dhe të përshtatshme, por mënyra më e mirë për të marrë një mesazh është që takoheni dhe të flisni.

GAFORJA

Ekziston një mundësi e veçantë që dikush të cilin e njihni mjaft mirë po ju lidh gjurmë romantike për të ndjekur. Ky person ose është shumë i turpshëm, ose tepër i frikësuar për të qenë i hapur ndaj jush, kështu që ju do të duhet të bëni një punë të vogël.

LUANI

Sot është koha për të mishëruar idetë tuaja dhe për të krijuar diçka që bota mund ta shohë si një shprehje të asaj që ju jeni. Kjo shprehje mund të jetë aq e komplikuar sa një shkrim i gjatë filozofik, ose i thjeshtë si një sanduç i shijshëm.

VIRGJERESHA

Nëse doni të krijoni një lidhje me dikë, çfarë po prisni? Personi të cilin i keni vënë syrin nuk do të jetë gjithmonë aty duke ju pritur. Është koha që të rritesh. Sigurisht do të ishte më mirë nëse ky person do të bënte lëvizjen e parë, por ky nuk është realiteti tani.

PESHORJA

Nuk ka asnjë arsye për t'u zotuar për një qëllim tani. Kur bëhet fjalë për misionet e jetës, duhet të cilin i keni përfunduar. Çfarëdo që kërkoni në jetë mund të ndryshojë nga dita në ditë, prandaj merrni në konsideratë zhvendosjen e angazhimeve tuaja aktuale.

AKREPI

Ju duhet të jeni shumë krenarë për mënyrën se si e keni trajtuar veten kohët e fundit. Kjo krenari do të vazhdojë t'ju çojë përpara, por ju duhet të jeni në vëzhgim për disa pengesa përjatë rrugës. Nëse hasni ndonjë pengesë, mos mendoni se keni humbur të gjithë magjinë tuaj.

SHIGJETARI

Sot ju do të jeni mjaft të ndjeshëm, kështu që mund të gjeni fymëzimin që keni kërkuar prej kohësh. Nëse jeni duke punuar mbi një projekt të vështirë, ose thjesht duke filluar një regjim të ri stërvitjeje, analizoni rezultatet përfundimtare.

BRICJAPI

Sot imagjinata juaj, ëndrrat dhe fantazitë do t'ju ofrojnë njerëzve të tjerë argëtim. Ju keni qenë në një mjegull të dendur rreth asaj se si ndjeheni për dikë dhe një bisedë me një mik të ngushtë të përbashkët do të sjellë disa qartësi.

UJORI

Askush nuk mund ta parashikojë të ardhmen, por sot mund t'i afroheni shumë asaj. Çështja është se tani instinktet tuaja janë aq të mprehta, saqë do të arrini të parandieni shumë zhvillime, prandaj mbështetuni tek ato, ose përdryshe këto ndjesi do të shkojnë dëm.

PESHQIT

Ju ndjeheni më të lidhur me njerëzit që shihni thuasje çdo ditë, por me siguri personalitetet e vërteta të këtyre njerëzve po fillojnë të shkelqejnë. Sot është një kohë e mirë për të kaluar dinamikën profesionale. Në dashuri jini më këmbëngulës.

PORTIERI KUJTON RINË E TIJ



Bufon: E kam tymosur ndonjë cigare hashash

Portieri i PSG-së, Xhanluixhi Bufon, ka rrefyer disa nga kujtimet e tij. Gjatë një intervistë për "Vanity Fair" veterani ka kujtuar kohët kur ishte ende 20 vjeç. "Në moshë të re isha një ultras. 'Ultra Indian Tips', ishte emri i tifogrupit që ndiqnim Karrarezen. E kam

ende të stampuar në dorezat e mia. Takoja njerëz nga të gjitha llojet, djem normalë, ëndërrimtarë, idealistë, interesantë, por edhe budallenj. E ndjenja veten të fuqishëm, të pathyeshëm, të aftë të bëja çfarë të doja. Kam bërë shumë budallëqe kur isha 20 vjeç, kam shijuar

gjithçka", kujton portieri. Më pasi ai rrefën edhe një histori të rrallë. "Jam kujdesur gjithmonë që të evitoj çdo lloj droge, maksimumi ndonjë cigare hashash. Mbaj mend si tani renë e tymit që mbulonte tifozët e Karrarezes. Ishte një mjegull që nuk vinte si pasojë e fishekzjarrëve apo tymuesve, por 200 cigare hashashi të tymosura në të njëjtën kohë", përfundon Bufon.



Neymar-Barça? Rikthimi nuk është më utopi

Nejmar mund të kthehet te Barcelona! Ky është lajmi më i fundit i "El Mundo Deportivo", që i referohet një takimi në Brazil të përfaqësuesve të sulmuesit aktual të PSG-së me Endri Kjurin, vëzhguesin "blaugrana" për Amerikën e Jugut. Palër, sipas medias pranë klubit katalan, kanë diskutuar mbi mundësinë e kthimit të Nejmarit në "Camp Nou". Mësohet se pjesëmarrës në takim ka qenë edhe Pini Zahavi, menaxheri izraelit që ishte përcaktues në kalimin e sulmuesit të PSG. Si dhe Alvaro Kosta, një ndërmjetës mes lojtarit dhe firmës së njohur të veshjeve sportive, "Nike". Transferimi te Barça i Nejmar nuk është një mision i pamundur. Sipas të përditshmes katalane, 26-vjeçari është pënuar që u largua nga Barça dhe nuk do të mendohej gjatë nëse do t'i jepej mundësia të bënte prapaktheu. Te Barcelona po qëndrojnë në pritje të momentit të duhur për të nisur zyrtarisht bisedimet. Sanskionet e mundshme të UEFA-s ndaj klubit parizien në lidhje me "fair play"-n financiar mund të japin një shtysë për arritjen e një marrëveshjeje. Nejmar u kushtoi arkave të PSG-së plot 222 milionë euro, sigurisht "blaugranat" nuk do ta paguanin këtë shifër për ta kthyer në "Camp Nou".

Veç sulmuesit të Interit, portugezi dëshiron në ekip edhe qendërmbrojtësin Skriniar

Nga Murinjo tek Eriksen, Perez do edhe Ikardin

Por si fillim duhet të kënaqen me Piatekun



Jeton Selimi

Pas shkarkimit nga stoli i Manchester Junajtid nisën menjëherë zërat rreth së ardhmes së Zhoze Murinjos. Në Angli janë të bindur, "Special one" po bëhet gati për t'u kthyer te Real i Madridit dhe nëse kjo ndodh, ai ka gati edhe kërkesat sa i përket merkatos. "Mbretërorët" janë në veshitirësi, çdo gjë duket sikur flet kundër tyre: rezultatet, loja dhe forma e dobët që po kalojnë disa prej atyre që vetëm një vit më parë gëzonin një formë të shkëlqyer. "Los Blancos" do të bëjnë ndryshime rrënjësore në staf dhe lojtarë. Pozitat e trajnerit aktual Santiago Solari janë lëkundur së tepërmi ditët e fundit. Presidenti i Realit, Florentino Perez, po bën çmos që portugezi të pranojë ofertën e tij. Numri një i klubit madrilen e vlerëson maksimalisht Murinjon dhe ardhja e tij po tentohet të realizohet që në janar. Nëse kjo nuk realizohet, atëherë me shumë gjasa në verë ky operacion duket plotësisht i mundshëm. Dy kërkesat e portugezit i janë paraqitur presidentit Perez, Ikardi dhe Skriniar. Real i rido të nisë pikërisht me këta dy emra, por në pritje për të mësuar fatet e stollit, drejtuesit madrilenë janë duke punuar në një pistë tjetër.



Florentino Perez duket i bindur për të sjellë në Madrid mesfushorin danez të Totenemit, Kristian Eriksen dhe është gati të kënaqë klubin anglez për ta bindur të pranojë transferimin. Mediat spanjolle raportojnë se Perez ka marrë kontaktet e para me presidentin e Totenemit, Daniel Levi, të cilit i ka bërë të ditur edhe ofertën e parë të madrilenëve. Mësohet se Perez ka shprehur gatishmërinë për të paguar plot 100 milionë euro për kartonin e danezit, ndërsa ka thënë se mund të përfshijë në operacion edhe fantazistin Izko, nëse anglezët kanë

interesi për të. Edhe trajneri i Totenhamit, Maurizio Pokeno e ka pranuar se Eriksen mund të largohet dhe se ai vetë do të ishte tërësisht kundër mbajtjes me zor të një futbollisti në skuadrën që ai drejton. Por nëse nga njëra anë Perez është gati të paguajë 100 milionë për Erik-

senin, në anën tjetër duket se nuk ka ndërmend ta dëmtojë buxhetin. Kjo për arsye se "fair-play" financiar qëndron pas derës së Perezit, që për të zgjidhur mungesën e golit të Bejl e Benzema, ka menduar një zgjidhje situatë disi qesharake për një klub si mbretërorët. Drejtuesit e Realit kanë nisur të mendojnë për një futbollist që mund të rivalizojë me të dy lojtarët dhe emri i parë në listë vjen nga Italia. Bëhet fjalë për Kristzof Piatek, për të cilin Real ka një ofertë qesharake në fakt. Mediat spanjolle tregojnë se Real po i trembet UEFA-s dhe nuk do që të bëjë transferim që mund të thyejë rregullin e "fair play"-t financiar. Për këtë arsye, ata synojnë që të huazojnë Piatekun, por huazimi do të jetë i thjeshtë dhe në fund të sezonit, ai të rikthehet te Xhenoa. Kjo ofertë veshitirë që të pranohet nga Xhenoa, që synon ta shesë polakun për një shumë të konsiderueshme.

AKUZON ISH-MESFUSHORI

Shkodra: Kukësi ende nuk më ka paguar

Donjet Shkodra është një nga lojtarët e larguar në këtë merkato dimri nga radhët e skuadrës së Kukësit. Mesfushori fantazist momentalisht po shijon pushimet e janarit dhe ende nuk ka vendosur për të ardhmen e tij. Në vendin tonë u përfol se klubi i Tiranës ishte interesuar për shërbimet e tij, por në fakt s'ka pasur asgjë të tillë. Sipas "Neesport.al"//, që ka kontaktuar vetë Shkodrën, ai tregon se nuk ndodhet në Shqipëri dhe gjasat për një rikthim në Superiore janë të pakta. Zbulon se ka mbyllur aventurën me Kukësin, por ende s'ka marrë të gjitha rrogat. "Jam duke pushuar pranë familjes sime. Është vërtetë që jam larguar dhe nga Kukësi, por ende nuk e kemi mbyllur çështjen e financave", ka deklaruar Shkodra.

NIS PROVËN ME PARTIZANIN

Mesfushori Dilaver Duka shfaqet në Antalia

Në Antalia, ku Partizani po zhvillon fazën përgatitore dimërore prej disa ditësh, ka mbërritur edhe përforcimi i tretë për trajnerin Skënder Gega. Ai është mesfushori Dilaver Duka, 29-vjeçari që vjen nga Amerika. Lajmin e ka konfirmuar klubi i kuq në faqen e vet zyrtare, ndërkohë që edhe drejtori Olsi Rama e kishte konfirmuar ardhjen e këtij futbollisti kohë më parë. Duka ka luajtur në Amerikë me skuadrën e ndryshme, së fundi me FC Motoun. Ai do të jetë një alternativë më shumë në mesfushën e Partizanit, ndërkohë që pozicioni natyral është ai i mesfushorit të majtë. Trajneri Gega do të shohë më mirë gjendjen e këtij futbollisti në miqësoret e Turqisë, që nisin nesër me atë ndaj Sivasporit. Duka është afërimi i tretë për skuadrën e kuqe në merkaton e dimrit, pas Fatjon Jusufit dhe Alesio Hysenit.


Atletiko Madrid ndjek shqiptarin

Hysajt, gjithnjë e më larg Napolit

E ardhmja e Hysajt duket gjithmonë e më larg Napolit. Mbrojtësi i Kombëtares sonë nuk po gjen hapësirat e duhura me Ancelotin dhe këtë po mundohet ta shfrytëzojnë klube të tjera. Atletiko Madridi po ndjek situatën dhe është gati ta sjellë në kryeqytet shqiptarin. Në fakt, mbërritja e tij në Spanjë duket do të përfshinte edhe një futbollist të Interit. Bëhet fjalë për kroatin Vrsaliko. Ky i fundit është huazuar tek zikaltrit nga Atletiko dhe italianët priten ta rikthejnë në shtëpi në fund të sezonit, pasi është larg pritshtëri. Në marrëveshje për të përfutur shërbimet e Hysajt mund të hyjë pikërisht kroatit Vrsaliko.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Një pije freskuese.
- Graf ish teniste.
- Dada, ish-diktator i Ugandës.
- Eshhtë pasuri e investuar.
- Mund të jenë fetare.
- Një pjesë e relaciotit.
- Fillojnë ambalazhimin.
- Një vegël.
- Që harkëtar i famshëm i akajve.
- Fillojnë hetimin.
- Një atentator vëtvërasës.
- Kështu janë takimet zyrtare.
- Eshhtë anije me dy skafte.
- Fundi i Turandot.
- Inicialet e Reitman regjisor.
- Farrell regjisor.
- Schneider që qe aktore.
- Mund të jetë e lirë për hartim.
- Emri i Pasternak.

- Ekberg e La dolce vita.
- Dikur quhej Mediolanum.
- Ruajnë pa ujë.
- Një mund të jetë kalendarik.
- Një është meskini, shpirtngushti.
- Një hidrokarbur.
- Mund të jetë franceskan.

VERTIKAL

- Jessica Parker aktore.
- Zola shkrimtar.
- Janë dritë të tilla me parsec.
- Mund të jenë gjaku.
- United Kingdom.
- Eshhtë njeri me principe.
- Një polimer për kirurgji estetike.
- Kufizojnë takimet.
- Difongoz teatral.
- Fillojnë fluturimin.
- Makina Uno.
- Eshhtë shpend lagune.
- Eshhtë operator që bën zoom.
- Eshhtë i pashpirt.
- Parashtesë për një.
- Pak enigmatike
- Një pjesë e Toskërisë.
- Agustini ish-bomber.
- Kufizojnë një princip.
- Miku i Batman.
- Tapeti për judo.
- Janë stadet në videogame.
- Bëhet një kundër vendimit.
- Janë me blerim mbuluar në një film
- Eshhtë shtet aziatik.
- Papavrami violinist
- Fadli komik
- Përhshendetja e Jul Qezarit.
- Mbyllin fushatat.
- Me të bëjnë një ketër.
- Mbyllin një takimin.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

- Një pemë gjigante.
- Janë për të kërcyer.
- Ishtë shkollë e Aristotelit
- Një thirrje me emra.
- Gjysmë rivale.
- Një pjesë e narkotikëve.
- Një tis... mjegulle
- E famshme ajo e Keopsit
- Mbyllin një sirtar
- Eshhtë ngjyrë e... fytyrës.
- Fillojnë lejen.
- Janë aktorë kryesorë.
- Janë kompozime të kënduara.
- Hudson aktore.
- Satelit i Uranit.
- Fillojnë tatëpjepën.
- Mbetur në fund.
- Sapo fillojnë.
- Kastile janë në fund.
- Kufij takimi.


- Ekstremet e tokës.
- Inicialet e Einstein.
- Qendër mësimi.
- Kështu thirrej Marco Pantani.
- Pak irredentizëm
- Fundi i një filmi.
- Popullojnë qytetin.
- Janë gojë vulkanesh
- Eshhtë edhe ai Persik.

VERTIKAL


- Mund të jetë sekrete në derë.
- Makina Agila.
- Ami i Maupassant.
- Mbyllin një sirtar.
- Rrëzohen me strike
- Luciano tenor i paharruar.
- Mbyllin këndet
- Eshhtë borxh.
- Mbyllin portat.
- Hagen rockstar.
- Një pjesë e akademisë.
- Bien me ballë.
- Një barkë lëkurëkuqsh.
- Atje ku shkollon progresisti
- Pallati i Dalaj Lamas në Lhasa
- Një pjesë e minoritetit.
- Eshhtë fluturues në ufo.
- Do të bëhen mace të tilla.
- Fletë pa kufij.
- I ka tek rendi.
- Kreshniku i volejbolli.
- Një det që është liqen në fakt.
- As unë, as ai.
- Në mes të King edhe Cole të muzikës.
- Një parashtesë zmadhuese.
- Eshhtë lon papagalli.
- Titulli i Sean Connery.
- Fillojnë panikun.
- Gjysma e rojave.
- Fitim pa kufij.
- Mbyllin një sherr.
- Fillojnë një metodë.
- Kufizojnë botimet.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

2	7		6	9	8			
	3	5						
1	9	4						3
		8	4					
	2			5		1	3	
		1	2	7				
			6	2			7	8
								5
7								

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	3	6	2	5	9	7	4	8
7	2	5	4	1	8	9	3	6
4	8	9	3	6	7	1	5	2
3	6	4	7	8	5	2	1	9
5	1	8	6	9	2	3	7	4
9	7	2	1	3	4	6	8	5
2	4	1	5	7	6	8	9	3
8	5	3	9	2	1	4	6	7
6	9	7	8	4	3	5	2	1

Argëtim filozofik

- Politikë është arti i ndarjen së një torte në mënyrë të tillë që të gjithë të besojnë se ka marrë copën më të madhe.

- Ka vetëm një mënyrë për të trajtuar një grua, por askush nuk e di atë.

- Kurrë mos ndjej keqardhje për atë që keni menduar për gruan tënde. Ajo ka menduar shumë më keq për ju.

- Vetëm një në 1000 burra bëhet lider. Pjesa tjetër 999 ndjekin gratë.

KRIPTOSKEME

8	A	1	11	16		7	5	15	8		3	8	
1	Z	8	12	8	6		6	8		4	3	9	12
2	I	7		10	8	9	2		15	2	11	3	2
9	L		14	8	12	17	12	3	7	9	9	2	
		5	7	15	5	8	5	2	16	8	5		16
4	8	6	5	2	15	8		7	15		10	7	
7	5	7		12	7	15		6	11	6	8	15	
5	6	4	7		5	2	18	2		11	19	7	
5	4	11	6	19			9	8		4	8	6	
9	11	15		1	7	5	8		19	8	1	8	
7	6	2	14		14	7		16	11	15	7		
5	7	8	4		8	9	3	8	15	7	5		

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

S	A	F	O	M	A	M	L	A	F		
A	N	A	K	O	S	T	U	M	E	R	
R	K	A	K	T	O	R	I	A	L	E	
A	L	K	L	E	O	P	A	T	R	A	
F	U	K	I	T	R	E	T	I	S		
L	A	N	G	E	K	I	B	F	K		
B	U	R	G	U	A	A	A	R	I	U	
A	R	T	A	L	N	U	R	A	T	A	
S	K	E	D	A	R	E	A	A	O	D	
M	I	L	A	O	M	E	B	U	R	R	
A	N	A	L	I	T	I	K	E	L	E	A
T	A	T	E	A	K	T	O	R	I	T	

PËRGJIGJE E FJALËKRYQJEVE TË KALUAR

M	A	T	T	C	A	S	T	T	N	T			
A	C	H	A	B	S	H	I	K	U	E	S	I	
L	E	B	I	P	T	R	A	N	S				
I	D	E	M	O	K	R	A	T	I	K	E		
I	P	A	L	E	S	T	I	N	E	Z	E	T	
M	A	N	A	S	T	I	R	E	T	E	O	R	
A	G	I	A	E	I	S	N	R					
T	A	R	T	A	R	I	O	T	S	J			
E	N	T	E	E	U	R	E	K	A	V	E		
R	E	A	L	E	R	E	P	A	R	T	E	T	
I	T	A	T	O	T	E	S	T	E	T			
A	A	T	L	A	S	T	E	R	I	C			
M	I	C	K	U	A	S	K	I	L	E	T		
I	L	R	T	R	O	M	A	N	E	T			
T	K	E	R	M	I	L	L	I	N	J	E		
B	A	N	A	N	E	T	M	A	D	E	M		
T	E	P	A	R	E	T	A	S	A	I			
H	A	R	E	I	A	N	P						
M	A	K	E	T	I	A	L	I	E	N	I		
O	R	E	T	L	E	G	A	K	A	P	O		
T	R	E	N	D	O	R	M	E	T	E	O	R	E
A	I	H	O	T	E	L	E	T	T	R	I	S	
T	I	M	O	T	E	T	A	M	A				



Thënie të mençura

- Një idiot mund të bëjë më shumë pyetje në një minutë se sa dhjetë burra të mençur mund të përgjigjen në një orë.
- Të pamartuarit dinë më shumë për gratë se sa të martuarit. Nëse nuk dinin, do të ishin dhe ata të martuar.
- Dhimbje koke: metodë kontraceptive, e përdorur kryesisht nga gratë.
- Një njeri i mençur mëson shumë nga një budalla, dhe një budalla nuk mëson asgjë nga një i mençur.

